UNIVERSITETI I EJL

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ

SEE UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

# ASPEKTET KUSHTETUESE, LIGJORE DHE PRAKTIKE TË ZGJEDHJEVE TË GJASHTA LOKALE TË TETORIT 2017 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

KANDIDATI:

Adem ETEMI

MENTORI:

Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI

Prill, 2023

**DEKLARATË**

Unë, Adem Etemi me ID 124458 deklaroj dhe vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi të magjistraturës me titull: **"ASPEKTET KUSHTETUESE, LIGJORE DHE PRAKTIKE TË ZGJEDHJEVE TË GJASHTA LOKALE TË TETORIT 2017 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT"** dhe se të gjitha referencat e shënuara në këtë punim si dhe citimet apo shërbimet e ndryshme të marrua nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqeje si dhe në fund të këtij punimi. Me këtë rast, po ashtu deklaroj se Universitetit ia barti të gjitha të drejtat autoriale të këtij punimi, për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese

P Ë R M B A J T J A


**P Ë R M B A J T J A**.........................................3

**ABSTRAKTI**.........................................5

**HYRJE**

.........................................12

1

**1. ANALIZA E MODELIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT** ....177

**1.1. Modeli i zgjedhjeve lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut**.........................................177

**1.2. Organet për realizimin e zgjedhjeve lokale** .........................................188

**1.3. E drejta aktive dhe pasive e votës në zgjedhjet lokale**.........................................210

**1.4. Numri i këshilltarëve komunalë në Republikën e Maqedonisë së Veriut**.........................................211

**1.5. Fushata parazgjedhore në zgjedhjet lokale dhe financimi i saj**.........................................2222

**1.6. Roli i mediave publike në zgjedhjet lokale** .........................................233

**1.7. Mbikëqyrja e zgjedhjeve lokale** .........................................244

**2. HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT** .........................................266

**2.1. Zgjedhjet e para lokale të v. 1996**.........................................26

**2.2. Zgjedhjet e dyta lokale të v. 2000** .........................................228

**2.3. Zgjedhjet e treta lokale të v. 2005** .........................................229

**2.4. Zgjedhjet e katërta lokale të v. 2009** .........................................30

**2.5. Zgjedhjet e pesta lokale të vitit 2013**.........................................31

**3. ANALIZA LIGJORE DHE PRAKTIKE E ZGJEDHJEVE LOKALE TË TETORIT 2017 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE REZULTATET E TYRE**.........................................333

**3.1. Përgatitja e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017** .........................................333

**3.2. Ndryshimet e fundit ligjore përkitazi me zgjedhjet lokale të tetorit 2017**.........................................355

**3.3. Pjesëmarrësit në zgjedhjet lokale të tetorit 2017** .........................................377

**3.3.1. Partitë politike dhe koalicionet**.........................................38

**3.3.1.1. VMRO-DPMNE**.........................................38

**3.3.1.2. Bashkimi Demokratik për Integrim** .........................................391

**3.3.1.3. Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë** .........................................4122

**3.3.1.4. Opsioni qytetar për Maqedoni** .........................................423

**3.3.1.5. Lëvizja Besa** .........................................433

**3.3.1.6. Lëvizja për unitet nacional të turqve**........................................................................444
**3.3.1.7. Partia Demokratike Shqiptare**.................................................................................444
**3.3.1.8. Koalicioni "Aleanca për shqiptarët" (Uniteti, RDK)**..............................................455
**3.3.1.9. Partia për Prosperitet Demokratik**.........................................................................466
**3.3.1.10. Levica**
..........................................................................................................467
**3.4. Fushata zgjedhore e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017 dhe financimi i saj**............................488
**3.5. Rezultatet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017**......................................................................511
**3.5.1. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave në RMV**..........................................................................................................52
**3.5.2. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave në RMV**..........................................................................................................60
**3.5.3. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetar dhe këshilltar të Qytetit të Shkupit**.............633
**3.5.4. Jehona e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017 dhe analiza krahasimore me zgjedhjet paraprake**..........................................................................................................655
**3.6. Mbrojtja juridike administrative dhe gjyqësore e të drejtës zgjedhore në zgjedhjet lokale të tetorit 2017**..........................................................................................................666
**3.7. Vlerësimet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017**.......................................................................83
**KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET**..........................................................................88
**BIBLIOGRAFIA**....................................................................................................................92

**ABSTRAKTI**

Në Maqedoninë e Veriut, modeli zgjedhor mazhoritar aplikohet për zgjedhjet e kryetarit të komunës, ndërsa modeli zgjedhor proporcional me metodën e DHontit për zgjedhjet për anëtarët e këshillave komunale. Në këtë punim analizohen edhe ndryshimet e Kodit Zgjedhor për këto zgjedhje. Në v. 2017 u bënë dy ndryshime të Kodit Zgjedhor. Fillimisht ndryshimi i Kodit Zgjedhor u bë për shkak të zhvendosjes së datës së parashikuar për zhvillimin e zgjedhjeve lokale nga muaji maj në muajin tetor, me ç’rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ua vazhdoi mandatin anëtarëve të këshillave dhe kryetarëve të komunave nga zgjedhjet e zhvilluara më 24 mars të vitit 2013 deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave, në gjysmën e parë të muajit tetor, ndërkaq, më 11 shtator të vitit 2017, u miratua edhe ndryshimi i dytë i Kodit Zgjedhor sipas të cilit Kuvendi i RMV-së e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e RMV-së, më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Në këtë drejtim, qëllimi kyç i këtij hulumtimi ka të bëjë me faktin që zhvillimit të këtyre zgjedhjeve lokale në vitin 2017 i parapriu një periudhë mjaft turbulente dhe dinamike e ndërthurur me shumë kthesa politike, ngjarje dhe trazira meqë pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016 kriza disavjeçare politike kulminoi me konstituimin e prolonguar të Parlamentit dhe zgjedhjen e Kryetarit të ri të Parlamentit Mr. Talat Xhaferi nga shumica e re parlamentare, thuaja 6 muaj pas zgjedhjeve parlamentare. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE në këto zgjedhje parlamentare fitoi 51 mandate të deputetëve, ndërsa Koalicioni I udhëhequr nga LSDM 49. BDI fitoi 10, BESA 5, Aleanca për Shqiptarët (ASH) 3 dhe PDSH 2 vende të deputetëve. Para fillimit të negociatave midis partive për formimin e koalicioneve për përbërjen e qeverisë së ardhshme, liderët e partive të shqiptarëve, ai i BDI – Ali Ahmeti, i BESA – Bilal Kasami dhe i Aleancës për Shqiptarët – Zijadin Sela, më 7 janar 2017 në Tiranë u takuan me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama me të cilin bashkërisht e nënshkruan të ashtuquajturën “Deklarata e partive shqiptare në Maqedoni”, e cila pastaj në opinionin publik u

bë e njohur si: “Platforma e Shqiptarëve” ose “Platforma e Tiranës”. Sipas nënshkruesve, qëllimi i Platformës ishte të sigurojë se çështjet e pazgjidhura të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut do të jenë çështje prioritare për qeverinë e ardhshme, pavarësisht se kush do ta formojë atë, ku ky document i përgatitur në Tiranë përmbante shtatë pika të cilat përfshinin kërkesa për barazi në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutën; zhvillim të barabartë rajonal; sundimin e së drejtës; krijimin e frymës së mirëbesimit në funksion të marrëdhënieve ndëretnike; zgjidhjen e kontestit me emrin; marrëdhënie të mira me fqinjët dhe integrimin e shpejtë Euro-Atlantik.

Në veçanti, rëndësia e veçantë e këtij punimi qëndron në faktin se, zakonisht çështja e zgjedhjeve lokale nuk është një temë me interes të veçantë për shkencat juridike dhe politike në Maqedoninë e Veriut, sepse duke u nisur nga hierarkia strukturore, zgjedhjet nacionale (parlamentare dhe zgjedhjet presidenciale) zakonisht kanë një avantazh të konsiderueshëm ndaj zgjedhjeve lokale, por me përjashtim të veçantë sepse meqë rezultatet e këtyre zgjedhjeve lokale plotësisht e ndryshuan numrin e kryetarëve të komunave midis VMRO-DPMNE dhe LSDM, ku koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi bindshëm duke fituar 57 vende të kryetarëve të komunave përfshi edhe Qytetin e Shkupit ndërkaq, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi vetëm pesë vende të kryetarëve të komunave, ndërkaq, BDI: 9, Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, e cila për herë të parë mori pjesë në këto zgjedhje si parti e veçantë politike, fitoi 3 kryetarë të komunave, ndërsa nga një kryetar komune fituan: BESA, PDSH dhe PDT, ndërkaq 3 vende të kryetarëve të komunave i fituan kandidatët e pavarur. Pas rivotimit, më 12 nëntor, BDI fitoi edhe një vend të kryetarit të komunës, me ç’rast kjo parti në këto zgjedhje fitoi gjithsej 10 vende të kryetarëve të komunave.

Në rrethin e parë të këtyre zgjedhjeve lokale, i cili u mbajt më 15 tetor të vitit 2017, në votim dolën gjithsej 1.079.876 nga gjithsej 1.814.644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve, me çka dalja në rrethin e parë ishte 59,51%. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve, dalja u zvogëlua dhe ishte 51,92%. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara lokale nga muaji mars i vitit 2013 dalja në rrethin e parë ishte 66,81% dhe në rrethin e dytë 64,9%. Dalja në këto zgjedhje lokale gjithashtu ishte më e ulët edhe nga dalja në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën më 11 dhjetor të vitit 2016 e cila ishte 66,79%. Në rrethin e parë, për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit për fletëvotime të pavlefshme u shpallën gjithsej

57.023 (4,3%). Nga fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, si të pavlefshme u shpallën gjithsej 65.048 fletëvotime (5%).

*Fjalët kyçe:* zgjedhjet lokale, modeli zgjedhor, fushata zgjedhore, jehona zgjedhore.

**АПСТРАКТ**

Во Северна Македонија, мнозинскиот изборен модел се применува за изборите за градоначалник на општината, додека пропорционалниот изборен модел со методот Донт се користи за изборите за членовите на општинските совети. Овој труд ги анализира и измените на Изборниот законик за овие избори. Во 2017 година беа направени две измени во Изборниот законик. Првично, промената на Изборниот законик беше направена поради поместување на датумот предвиден за одржување на локалните избори од мај во октомври, во кој случај Собранието на Република Македонија го продолжи мандатот на членовите на советите и на градоначалници на општините од одржаните избори на 24 март 2013 година до изборот на нови членови на советници и градоначалници, во првата половина на октомври, додека на 11 септември 2017 година беше одобрена и втората измена на Изборниот законик, според кој Собранието го усогласува составот на Државната изборна комисија со резултатите од последните избори за пратеници во Собранието, најдоцна 30 дена пред изборите.

Во таа насока, клучната цел на ова истражување е поврзана со фактот дека на развојот на овие локални избори во 2017 година му претходеше прилично турбулентен и динамичен период со многу политички пресврти, настани и немири откако се одржаа предвремените парламентарни избори на 11 декември 2016 година, неколкугодишната политичка криза кулминираше со продолженото конституирање на Собранието и изборот на новиот претседател на Собранието, г. Талат Џафери од новото парламентарно мнозинство, 6 месеци по парламентарните избори. Коалицијата предводена од ВМРО-ДПМНЕ на овие парламентарни избори освои 51 пратенички мандат, додека коалицијата предводена од СДСМ 49. ДУИ освои 10, БЕСА 5, Алијансата за Албанците 3, а ДПА 2 пратенички места. Пред почетокот на преговорите меѓу партиите за формирање коалиции за состав на идната влада, лидерите на албанските партии, на ДУИ - Али Ахмети, на БЕСА -

Билал Касами и на Алијансата за Албанците - Зијадин Села , на 7 јануари 2017 година во Тирана се сретнаа со премиерот на Албанија, Еди Рама, со кого заеднички ја потпишаа таканаречената „Декларација на албанските партии во Македонија", која подоцна во јавноста стана позната како: „Платформа на Албанците" или „Платформа на Тирана". Според потписниците, целта на Платформата била да се осигура дека нерешените прашања на Албанците во Северна Македонија ќе бидат приоритетно прашање за идната влада, без разлика кој ќе ја формира, каде што овој документ подготвен во Тирана содржеше седум точки во кои беа вклучени барањето за еднаквост во согласност со Охридскиот договор и Уставот; правичен регионален развој; владеење на правото; создавање дух на добра волја во функција на меѓуетничките односи; решавање на спорот со името; добри односи со соседите и брза евроатланска интеграција.

Особено, посебното значење на овој труд лежи во фактот што, вообичаено, прашањето за локалните избори не е тема од посебен интерес за правните и политичките науки во Северна Македонија, бидејќи тргнувајќи од структурната хиерархија, националните избори (парламентарни и претседателски избори) вообичаено имаат значителна предност во однос на локалните избори, но со посебен исклучок бидејќи резултатите од овие локални избори целосно го променија бројот на градоначалници меѓу ВМРО-ДПМНЕ и СДСМ, каде коалицијата предводена од СДСМ убедливо победи со освојување на 57 пратенички места. градоначалниците, вклучително и Град Скопје, пак, коалицијата предводена од ВМРО-ДПМНЕ освои само пет градоначалнички места, додека ДУИ: 9, Алијансата на политичката партија за Албанците, која за прв пат учествуваше на овие избори, како посебна политичка партија освои 3 градоначалници, додека еден градоначалник освоија: БЕСА, ДПА и ПДТ, додека 3 градоначалници освоија независни кандидати. По прегласувањето, на 12 ноември, ДУИ доби уште едно место за градоначалник на општината, со што оваа партија на овие избори освои вкупно 10 места за градоначалник на општините.

Во првиот круг од овие локални избори, кој се одржа на 15 октомври 2017 година, на гласање излегоа вкупно 1.079.876 од вкупно 1.814.644 запишани во избирачкиот список, со што излезеноста во првиот круг беше 59, 51%. Во вториот круг од изборите излезеноста

се намали и изнесуваше 51,92%. Споредено со претходните локални избори од март 2013 година, излезноста во првата област е 66,81 отсто, а во втората 64,9 отсто. Излезноста на овие локални избори беше и помала од излезноста на предвремените парламентарни избори кои се одржаа на 11 декември 2016 година, која изнесуваше 66,79%. Во првиот круг вкупно 57.023 (4,3%) гласачки ливчиња беа прогласени за неважечки за избор на градоначалници на општини и градоначалник на Град Скопје.

*Клучни зборови:* локални избори, изборен модел, изборна кампања, изборна излезност.

**ABSTRACT**

In North Macedonia, the majority election model is applied for the elections of the mayor of the municipality, while the proportional election model with the Dhont method is used for the elections for the members of the municipal councils. This paper also analyzes the changes to the Electoral Code for these elections. In 2017, two changes were made to the Electoral Code. Initially, the change of the Electoral Code was made due to the shift of the date foreseen for the holding of local elections from May to October, in which case the Assembly of the Republic of Macedonia continued the mandate of the members of the councils and the mayors of the municipalities from the held elections on March 24, 2013 until the election of new members of councilors and mayors, in the first half of October, meanwhile, on September 11, 2017, the second amendment to the Electoral Code was also approved, according to which the Assembly harmonizes the composition of the State Election Commission with the results of the last elections for deputies in the Assembly, no later than 30 days before the elections.

In this regard, the key purpose of this research is related to the fact that the development of these local elections in 2017 was preceded by a rather turbulent and dynamic period interspersed with many political turns, events and riots since the early parliamentary elections were held on On December 11, 2016, several years of political crisis culminated with the prolonged constitution of the Parliament and the election of the new Speaker of the Parliament, Mr. Talat Xhaferi from the new parliamentary majority, 6 months after the parliamentary elections. The coalition led by VMRO-DPMNE in these parliamentary elections won 51 seats of deputies, while the Coalition led by SDSM 49. DUI won 10, BESA 5, Alliance for Albanians (ASH) 3

and PDSH 2 seats of deputies. Before the start of the negotiations between the parties for the formation of coalitions for the composition of the future government, the leaders of the Albanian parties, that of DUI - Ali Ahmeti, of BESA - Bilal Kasami and of the Alliance for Albanians - Zijadin Sela, on January 7, 2017 in Tirana they met with the Prime Minister of Albania, Edi Rama, with whom they jointly signed the so-called "Declaration of Albanian parties in Macedonia", which later became known in the public opinion as: "Platform of Albanians" or "Platform of Tirana". According to the signatories, the purpose of the Platform was to ensure that the unresolved issues of Albanians in North Macedonia will be a priority issue for the next government, regardless of who will form it, where this document prepared in Tirana contained seven points which included the demand for equality in accordance with the Ohrid Agreement and the Constitution; equitable regional development; the rule of law; creating a spirit of good faith in the function of inter-ethnic relations; resolution of the dispute with the name; good relations with neighbors and rapid Euro-Atlantic integration.

In particular, the special importance of this paper lies in the fact that, usually, the issue of local elections is not a topic of special interest for legal and political sciences in North Macedonia, because starting from the structural hierarchy, national elections (parliamentary and presidential elections) usually have a significant advantage over local elections, but with a special exception because the results of these local elections completely changed the number of mayors between VMRO-DPMNE and SDSM, where the coalition led by SDSM won convincingly by winning 57 seats of mayors, including the City of Skopje, meanwhile, the coalition led by VMRO-DPMNE won only five seats of mayors, meanwhile, DUI: 9, the Political Party Alliance for Albanians, which for the first time participated in these elections, as a separate political party, won 3 mayors, while one mayor was won by: BESA, PDSH and PDT, while 3 seats of mayors were won by independent candidates. After the re-voting, on November 12, DUI won another seat of the mayor of the municipality, in which case this party won a total of 10 seats of the mayor of the municipalities in these elections.

In the first round of these local elections, which was held on October 15, 2017, a total of 1,079,876 out of a total of 1,814,644 voters registered in the voter list came out to vote, with the result that the turnout in the first round was 59, 51%. In the second round of elections, the

turnout decreased and was 51.92%. Compared to the previous local elections from March 2013, the turnout in the first district was 66.81% and in the second district 64.9%. The turnout in these local elections was also lower than the turnout in the early parliamentary elections which were held on December 11, 2016, which was 66.79%. In the first round, a total of 57,023 (4.3%) ballots were declared invalid for the election of mayors of municipalities and the mayor of the City of Skopje.

*Key words:* local elections, election model, election campaign, election turnout.

## HYRJE

### Lënda e hulumtimit

Lënda e këtij hulumtimi është analiza kushtetuese, ligjore dhe praktike e zgjedhjeve të gjashta lokale që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut, të cilat u mbajtën më 15 tetor 2017 (rrethi i parë) dhe 29 tetor 2017 (rrethi i dytë) në 80 komuna dhe në qytetin e Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Në Maqedoninë e Veriut, modeli zgjedhor mazhoritar aplikohet për zgjedhjet e kryetarit të komunës, ndërsa modeli zgjedhor proporcional me metodën e DHontit për zgjedhjet për anëtarët e këshillave komunale. Në këtë punim do të analizohen edhe ndryshimet e Kodit Zgjedhor për këto zgjedhje. Në v. 2017 u bënë dy ndryshime të Kodit Zgjedhor. Fillimisht ndryshimi i Kodit Zgjedhor u bë për shkak të zhvendosjes së datës së parashikuar për zhvillimin e zgjedhjeve lokale nga muaji maj në muajin tetor, me ç'rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ua vazhdoi mandatin anëtarëve të këshillave dhe kryetarëve të komunave nga zgjedhjet e zhvilluara më 24 mars të vitit 2013 deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave, në gjysmën e parë të muajit tetor, ndërkaq, më 11 shtator të vitit 2017, u miratua edhe ndryshimi i dytë i Kodit Zgjedhor sipas të cilit Kuvendi i RMV-së e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e RMV-së, më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Në veçanti, rëndësia e veçantë e këtij punimi qëndron në faktin se, zakonisht çështja e zgjedhjeve lokale nuk është një temë me interes të veçantë për shkencat juridike dhe politike në Maqedoninë e Veriut, sepse duke u nisur nga hierarkia strukturore, zgjedhjet nacionale (parlamentare dhe zgjedhjet presidenciale) zakonisht kanë një avantazh të konsiderueshëm ndaj zgjedhjeve lokale, por me përjashtim të veçantë sepse meqë rezultatet e këtyre zgjedhjeve lokale plotësisht e ndryshuan numrin e kryetarëve të komunave midis VMRO-DPMNE dhe LSDM, ku koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi bindshëm duke fituar 57 vende të kryetarëve të komunave përfshi edhe Qytetin e Shkupit ndërkaq, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi vetëm

pesë vende të kryetarëve të komunave, ndërkaq, BDI: 9, Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, e cila për herë të parë mori pjesë në këto zgjedhje si parti e veçantë politike, fitoi 3 kryetarë të komunave, ndërsa nga një kryetar komune fituan: BESA, PDSH dhe PDT, ndërkaq 3 vende të kryetarëve të komunave i fituan kandidatët e pavarur. Pas rivotimit, më 12 nëntor, BDI fitoi edhe një vend të kryetarit të komunës, me ç'rast kjo parti në këto zgjedhje fitoi gjithsej 10 vende të kryetarëve të komunave.

Në rrethin e parë të këtyre zgjedhjeve lokale, i cili u mbajt më 15 tetor të vitit 2017, në votim dolën gjithsej 1.079.876 nga gjithsej 1.814.644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve, me çka dalja në rrethin e parë ishte 59,51%. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve, dalja u zvogëlua dhe ishte 51,92%. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara lokale nga muaji mars i vitit 2013 dalja në rrethin e parë ishte 66,81% dhe në rrethin e dytë 64,9%. Dalja në këto zgjedhje lokale gjithashtu ishte më e ulët edhe nga dalja në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën më 11 dhjetor të vitit 2016 e cila ishte 66,79%. Në rrethin e parë, për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit për fletëvotime të pavlefshme u shpallën gjithsej 57.023 (4,3%). Nga fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, si të pavlefshme u shpallën gjithsej 65.048 fletëvotime (5%).

## Qëllimet e hulumtimit

Zgjedhjet lokale në literaturën kushtetuese zakonisht quhen: "zgjedhje me stimul të ulët", me kuptimin se, nga ky rregull ka përjashtime, që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme ose situata të veçanta konflikti politik, ku zgjedhjet lokale mund të kenë edhe një stimul të lartë. Prandaj, qëllimi kyç i këtij hulumtimi ka të bëjë me faktin që zhvillimit të këtyre zgjedhjeve lokale në vitin 2017 i parapriu një periudhë mjaft turbulente dhe dinamike e ndërthurur me shumë kthesa politike, ngjarje dhe trazira meqë pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016 kriza disavjeçare politike kulminoi me konstituimin e prolonguar të Parlamentit dhe zgjedhjen e Kryetarit të ri të Parlamentit Mr. Talat Xhaferi nga shumica e re parlamentare, thuaja 6 muaj pas zgjedhjeve parlamentare. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE në këto zgjedhje parlamentare fitoi 51 mandate të deputetëve, ndërsa

Koalicioni I udhëhequr nga LSDM 49. BDI fitoi 10, BESA 5, Aleanca për Shqiptarët (ASH) 3 dhe PDSH 2 vende të deputetëve. Para fillimit të negociatave midis partive për formimin e koalicioneve për përbërjen e qeverisë së ardhshme, liderët e partive të shqiptarëve, ai i BDI – Ali Ahmeti, i BESA – Bilal Kasami dhe i Aleancës për Shqiptarët – Zijadin Sela, më 7 janar 2017 në Tiranë u takuan me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama me të cilin bashkërisht e nënshkruan të ashtuquajturën "Deklarata e partive shqiptare në Maqedoni", e cila pastaj në opinionin publik u bë e njohur si: "Platforma e Shqiptarëve" ose "Platforma e Tiranës". Sipas nënshkruesve, qëllimi i Platformës ishte të sigurojë se çështjet e pazgjidhura të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut do të jenë çështje prioritare për qeverinë e ardhshme, pavarësisht se kush do ta formojë atë, ku ky document i përgatitur në Tiranë përmbante shtatë pika të cilat përfshinin kërkesa për barazi në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutën; zhvillim të barabartë rajonal; sundimin e së drejtës; krijimin e frymës së mirëbesimit në funksion të marrëdhënieve ndëretnike; zgjidhjen e kontestit me emrin; marrëdhënie të mira me fqinjët dhe integrimin e shpejtë Euro-Atlantik.

## Hipotezat e hulumtimit

Gjatë hulumtimit shkencor do të paraqesim disa hipoteza të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen:

1. Sistemi zgjedhor në RMV është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe evropiane;
2. Kodi Zgjedhor i RMV-së i përmban të gjitha dispozitat e nevojshme ligjore për organizimin e zgjedhjeve lokale;
3. Zgjedhjet e gjashta lokale në RMV ishin kredibile dhe kompetitive;
4. Partitë kryesore parlamentare gëzojnë avantazhe sistematike, veçanërisht në shpërndarjen e burimeve publike për fushatë, duke përfshirë edhe median;
5. Në këto zgjedhje lokale, kandidatët e partive më të mëdha, në pjesën më të madhe, u përmbajtën nga retorika sulmuese në baza etnike, ndërsa një pjesë e partive politike i përkushtuan vëmendje edhe votuesve të bashkësive të tjera etnike; dhe

6. Mungesa e temave reale lokale gjatë fushatës zgjedhore si dhe fushata e zezë denigruese ishin faktori kryesor që zgjedhjet e gjashta lokale të v. 2017 në RMV të kenë jehonë më të ulët zgjedhore se zgjedhjet paraprake lokale të v. 2013.

## Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim të magjisraturës do të shfrytëzohet literaturë hulumtuese e ndryshme duke filluar nga tekstet universitare, studime, raporte dhe publikime të tjera që kanë të bëjnë me temën e caktuar, etj.

Metodat që do të përdoren janë :

- Metoda historike - do të përdoret kjo metodë që të hulumtohet historiku i zgjedhjeve lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga pavarësimi respektivisht nga zgjedhjet e para lokale të v. 1996.

- Metoda juridike – do të shqyrtohen dhe analizohen zgjidhjet dhe reformat ligjore të legjislacionit zgjedhor në RMV përkitazi me këto zgjedhje të gjashta lokale në RMV.

- Metoda statistikore – do të shqyrtohen rezultatet zgjedhore e të gjithë pjesëmarrësve në këto zgjedhje.

-Metoda komparative – do të bëhen krahasimet e duhura të zgjedhjeve lokale në RMV mes vete si dhe të zgjidhjeve të ndryshme ligjore.

## Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në atë se elaborimi, analiza dhe rekomandimet e bëra në lidhje me sistemin zgjedhor për zgjedhjet lokale çdoherë janë të rëndësishme në një vend me sistem demokratik.

Çdo demokraci lokale ka nevojë që herë pas herë të testojë funksionalitetin dhe efikasitetin e institucioneve të saj lokale, e zgjedhjet lokale janë ato që pikërisht e mundësojnë këtë gjë. Si një prej instrumenteve më të rëndësishme të demokracisë lokale sot, zgjedhjet lokale shërbejnë si rrugë për pjesëmarrje të qytetarëve në procese politike lokale, duke i zgjedhur zyrtarët lokalë që përfaqësojnë më së miri vlerat dhe interesat e popullit, votuesit mund të

ndikojnë në formësimin e politikave lokale publike që përmirësojnë kualitetin e jetës së tyre në komunat si njësi të qeverisjes lokale në RMV.

Një aspekt tjetër i rëndësisë së këtij hulumtimi është edhe mbrojtja juridike administrative dhe gjyqësore e të drejtës zgjedhore në RMV, ku në këto zgjedhje lokale në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, në rrethin e parë u paraqitën gjithsej 47 kundërshtime në lidhje me procedurën e votimit. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE paraqiti 43 kundërshtime, 2 kundërshtime paraqiti Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM), ndërsa nga një kundërshtim paraqitën Aleanca për Shqiptarët (A/SH) dhe LEVICA. Të gjitha kundërshtimet e paraqitura u hodhën poshtë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Në Gjykatën Administrative u paraqitën gjithsej 28 padi kundër vendimeve të KSHZ. Prej tyre 24 padi u paraqitën nga VMRO-DPMNE, 2 padi nga BPRM dhe nga një padi nga Aleanca për Shqiptarët dhe LEVICA. Të gjitha paditë e paraqitura u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative. Pas mbajtjes së rrethit të dytë më 29 tetor, u paraqitën gjithsej 102 kundërshtime. Lëvizja BESA paraqiti 89 kundërshtime, Aleanca për Shqiptarët paraqiti 12 kundërshtime dhe Lëvizja Popullore për Maqedoni paraqiti një kundërshtim. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet, me ç'rast në Gjykatën Administrative u paraqitën 11 padi nga Aleanca për Shqiptarët, 4 padi nga Lëvizja BESA dhe një nga Lëvizja Popullore për Maqedoni. Prej këtij numri të padive, Gjykata Administrative i hodhi poshtë 15 padi, ndërsa pranoi një padi të Lëvizjes BESA. Me pranimin e kësaj padie, votimi nga rrethi i dytë u përsërit në vendvotimin 2901 në Komunën e Çairit. Për rivotimin nuk kishte kundërshtime të paraqitura. Por, kundërshtimet e paraqitura në rrethin e parë dhe të dytë nuk ndikuan mbi ndryshimin e rezultateve të zgjedhjeve.

## KAPITULLI I PARË

## ANALIZA E MODELIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### 1.1. Modeli i zgjedhjeve lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Modeli zgjedhor për zgjedhjet lokale në RMV është përcaktuar me Kodin zgjedhor, ku përcaktohet se, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet për kryetarë komunash në njësitë e vetëqeverisjes lokale zhvillohen sipas modelit zgjedhor të shumicës, ndërsa zgjedhjet për anëtarë të këshillave në njësitë e vetëqeverisjes lokale sipas modelit zgjedhor proporcional me çrast, zgjedhjet për kryetarë dhe anëtarë të këshillit mbahen çdo katër vjet, njëkohësisht në të gjitha njësitë, në gjysmën e dytë të tetorit dhe Kryetari i Kuvendit i shpall zgjedhjet me akt përkatës i cili publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më shumë se 90 e më pak se 70 ditë, ku zgjedhja e kryetarit në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet sipas modelit zgjedhor mazhoritar dhe për kryetar komune zgjidhet kandidati që ka fituar shumicën e votave në raundin e parë të votimit, nëse dalin së paku një e treta e zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes lokale por, nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet e kërkuara, zgjedhjet përsëriten në raundin e dytë për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota dhe, nëse në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat dhe ai nuk fiton shumicën e kërkuar, procedura e zgjedhjes përsëritet kurse, raundi i dytë i votimit zhvillohet 14 ditë pas përfundimit të të parit dhe në raundin e dytë zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave[1].

[1] Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxwI2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view.

Në zgjedhjen e këshilltarëve në vetëqeverisjen lokale përdoret modeli proporcional dhe ndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hontit[2]. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me serinë e pjesëtuesve 1, 2, 3 ... deri në numrin e anëtarëve të këshillit që zgjidhen në njësinë specifike të vetëqeverisjes lokale dhe kuotat e marra në këtë mënyrë renditen sipas madhësisë, duke marrë parasysh koeficientët më të mëdhenj sa janë zgjedhur anëtarë të këshillit dhe një listë e kandidatëve merr aq anëtarë këshilli sa ka kuotat më të mëdha nga ata që konsiderohen[3].

### 1.2. Organet për realizimin e zgjedhjeve lokale

Organe të cilat i zbatojnë zgjedhjet janë: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ), si dhe këshillat zgjedhorë në përfaqësitë diplomatike-konsullore, ku në bazë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të parashikuara me Marrëveshjen e Përzhinos, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga nëntë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve që funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale me mandat prej pesë vitesh dhe e kanë të drejtën e rizgjedhjes dhe anëtarët e KSHZ zgjidhen në afat prej 30 ditësh para skadimit të afatit të përbërjes ekzistuese ku KSHZ ka një përbërje partiake eksperte, me ç’rast gjashtë anëtarë të tij janë përfaqësues të partive politike të përfaqësuara në Kuvend, ndërsa tre anëtarë zgjidhen sipas propozimit të përbashkët të partive në pushtet dhe partive opozitare, përkatësisht nga radhët e kandidatëve të paraqitur, ku, partia në pushtet me numër më të madh të deputetëve propozon dy anëtarë, partia e dytë sipas madhësisë në pushtet propozon një anëtar, ndërkaq, partia më e madhe politike në opozitë propozon dy anëtarë, ndërsa partia e dytë për nga madhësia në opozitë propozon një anëtar, dhe Kryetari dhe nënkryetari i KSHZ zgjidhen nga Kuvendi nga

---

[2] Për më tepër mbi metodën e DHontit shih në: Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, Furkan-ISM, Shkup, 2020, fq. 285-288.

[3] Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxwI2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view; dhe Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, 2017, fq. 34.

radhët e anëtarëve të propozuar sipas propozimit të përbashkët nga partitë në pushtet dhe nga ato opozitare, me ç'rast kryetari ose nënkryetari duhet të jetë nga radhët e pjesëtarëve të bashkësisë më të madhe e cila nuk është në shumicë[4].

KSHZ emëron sekretar të përgjithshëm i cili udhëheq me shërbimin profesional i cili i kryen punët profesionale – administrative dhe punët organizative – teknike, ku me ndryshimet e fundit të datës 11 shtator 2017, është shtuar një nen i ri në Kodin Zgjedhor, në të cilin parashikohet se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve[5].

KSHZ është përgjegjëse për mbajtjen e Listës së Zgjedhësve në të cilën regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, të cilët kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe ata të cilët janë me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, të cilët kanë letërnjoftim të vlefshëm ose dokument të vlefshëm udhëtimi; në Listën e Zgjedhësve nuk regjistrohen ata qytetarë të cilët e kanë humbur zotësinë e veprimit me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor, ndërkaq, komisionet komunale zgjedhore (KKZ), të cilat formohen në nivel të çdo komune, ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin që është në kompetencë të tyre dhe kryejnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë dhe përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili nga anëtarët ka zëvendës; anëtarët dhe zëvendësit e KKZ zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, me arsim të lartë për mandat prej pesë vitesh dhe zgjedhjen e tyre e bën KSHZ sipas zgjedhjes së rastësishme pas pranimit të evidencës me të dhënat për administratën shtetërore dhe komunale, administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratën publike[6].

Përbërja e këshillave zgjedhorë paraqet një kombinim të të punësuarve në administratën shtetërore dhe komunale (kryetari, zëvendëskryetari, dy anëtarë dhe zëvendës të tyre), si dhe përfaqësues të partive politike, ku një anëtar dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë opozitare, të cilat kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe nga një anëtar dhe

[4] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 34-35.
[5] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 125/17.
[6] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 35-36.

zëvendës të tyre propozojnë partitë që e kanë fituar pushtetin në zgjedhjet e fundit parlamentare, ndërkaq, mandati i anëtarëve të këshillave zgjedhorë është 4 vjeçar dhe zgjedhjen e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bën KKZ dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit për rajonin për të cilin janë përgjegjës, sipas aktit paraprak të KSHZ-së, ku në ato komuna, në të cilat jetojnë më së paku 20% të qytetarëve që u takojnë bashkësive jo shumicë, zbatohet principi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat gjatë përbërjes së KKZ-së dhe këshillave zgjedhorë ndërkaq, ligji parashikon përfaqësim prej më së paku 30% të çdo gjinie në përbërjen e organeve zgjedhore dhe anëtarët e KKZ-së dhe të këshillave zgjedhorë nuk mund të jenë funksionarë të zgjedhur ose të emëruar nga Qeveria, Kuvendi dhe persona të punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatit Ligjvënës, Entit Shtetëror të Statistikës, Qendrës për Menaxhim me Kriza, shërbimet profesionale të Gjykatës Administrative, KSHZ-së dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe organet zgjedhore punojnë dhe marrin vendime nëse në mbledhjet e tyre merr pjesë shumica e anëtarëve ku në rast të mungesës së anëtarit të KKZ-së, Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe Këshillit Zgjedhor, në punime marrin pjesë zëvendësit e atyre anëtarëve, po ashtu të zgjedhur nga KSHZ dhe vendimet në të gjitha organet zgjedhore merren me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve[7].

### 1.3. E drejta aktive dhe pasive e votës në zgjedhjet lokale

Në zgjedhjet lokale në RMV, të drejtë vote ka çdo shtetas i RMV-së i cili ka mbushur moshën 18 vjeçare dhe i cili është ligjërisht i aftë dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore, komunën, përkatësisht qytetin e Shkupit ku mbahen zgjedhjet dhe votimi është i fshehtë dhe askush nuk duhet t'i kërkojë llogari zgjedhësit për votën, as t'i kërkojë atij ose asaj të thotë se për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar ndërkaq, KSHZ-ja është përgjegjëse për informimin dhe edukimin e qytetarëve për mënyrën e votimit dhe ushtrimin e të drejtës së votimit, ndërsa në vendvotime dhe në ekranin e votimit shfaq udhëzimet për votim në maqedonisht, shqip, turqisht, vllahisht, serbisht, gjuha rome dhe boshnjake dhe në sallën e

---

[7] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Udhëzimi për mënyrën e emërimit të anëtarëve të këshillave zgjedhore me propozim të partive politike për Zgjedhjet lokale, të cilat do të zhvillohen më 15 tetor 2017.

votimit afishohen edhe listat e kandidatëve ku kandidat për kryetar komune ose këshilli mund të jetë personi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka zotësi të veprimit ndërkaq, personi që është dënuar me dënim të formës së prerë me vendim të gjykatës për burgim pa kushte mbi 6 muaj, vuajtja e të cilit nuk ka filluar, ose është duke vuajtur dënimin për një krim, nuk mund të jetë kandidat për këto pozicione, kështu që, krahas këtyre kushteve, kandidati për kryetar komune ose anëtar këshilli duhet të ketë vendbanim të përhershëm në njësinë e vetëqeverisjes lokale për të cilën kandidon[8].

### 1.4. Numri i këshilltarëve komunalë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, këshilli i komunës paraqet organin kolegjial përfaqësues të qytetarëve, të cilin e përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë ku anëtarët e këshillit zgjedhen me mandat katërvjeçar, i përfaqësojnë qytetarët dhe në këshill vendosin sipas bindjeve të tyre dhe anëtari i këshillit nuk mund të revokohet[9].

Këshilli përbëhet prej 9 deri 33 anëtarëve varësisht nga numri i banorëve në komunë, edhe atë:

**TABELA 1:**
**Numri i anëtarëve të Këshillit të Komunës sipas numrit të banorëve në Komunë[10]**

| Numri i banorëve | Numri i anëtarëve të Këshillit |
|---|---|
| deri 5.000 | 9 |
| prej 5.001 deri 10.000 | 11 |
| prej 10.001 deri 20.000 | 15 |
| prej 20.001 deri 40.000 | 19 |
| prej 40.001 deri 60.000 | 23 |
| prej 60.001 deri 80.000 | 27 |
| prej 80.001 deri 100.000 | 31 |
| mbi 100.000 | 33 |

[8] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, 2017, fq. 38.
[9] Për më tepër shih në: Ligji për vetëqeverisje lokale, nenet 31-34, “Gazeta zyrtare e RMV-së”, nr. 5/2002.
[10] Po aty.

### 1.5. Fushata parazgjedhore në zgjedhjet lokale dhe financimi i saj

Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe mund të zgjas deri 24 orë para fillimit të zgjedhjeve; fushatë zgjedhore nuk guxon të zhvillohet në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve ndërkaq, fushata zgjedhore për këto zgjedhje lokale filloi më 25 shtator të vitit 2017 në orën 00:00 ndërkaq, fushata zgjedhore për rrethin e parë përfundoi më 13 tetor 2017 në ora 24:00, ndërsa fushata zgjedhore për rrethin e dytë përfundoi më 27 tetor 2017 në ora 24:00[11].

Organizatorët e fushatës zgjedhore, më së voni 48 orë pas verifikimit të listave të kandidatëve, duhet të hapnin llogari të veçantë bankare dhe vetëm përmes saj mund të financohej fushata dhe nuk mund të shfrytëzohej për dedikime të tjera, andaj, fushata mund të financohej edhe nga pagesa e anëtarësisë së partive politike dhe nga donacionet të cilat nuk mund të jenë më të larta se 3.000-euro për persona fizikë dhe 30.000-euro për persona juridikë, ku fushata mund të financohej me para, sende dhe shërbime, vlera e të cilave nuk guxon t'i tejkalojë këto shuma dhe, nëse lartësia e donacionit është më e madhe nga shuma e lejuar, pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë që, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të donacionit, dallimin ndërmjet vlerës së lejuar dhe të donuar ta bartë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë; pjesëmarrësit e fushatës zgjedhore kanë të drejtë të shpenzojnë më së shumti deri më 110 denarë për një zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore për të cilën ka paraqitur listë të kandidatëve, 70 denarë më pak sesa që ishte e lejuar në zgjedhjet e vitit 2014, ndërkaq, fushata zgjedhore nuk mund të financohej me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, nga mjetet e kompensimeve të shpenzimeve për zgjedhje të cilat i posedojnë organizatorët e fushatës zgjedhore dhe as nga mjetet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, nga mjetet e shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, nga mjetet e qeverive të huaja dhe

---

[11] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve Kalendari për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për anëtarë të këshillave të komunave dhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit, si dhe për kryetarë të komunave dhe për kryetar të Qytetit të Shkupit, 07 gusht 2017.

institucioneve ndërkombëtare, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët ku kapitali i huaj është dominant, por edhe nga burime të paidentifikuara, mirëpo, me ndryshimet e reja ligjore radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit), si dhe personat e tyre të ndërlidhur nuk guxojnë të financojnë ose t'u dhurojnë partive politike, përfshirë edhe fushata, ku, si persona të ndërlidhur konsiderohen anëtarët e familjes, të familjes së bashkëshortit- bashkëshortes ose shokut jashtë martesor, personat të cilët kanë hise në pronësi, personat të cilët marrin pjesë në menaxhim, personat të cilët një periudhë të gjatë kohore me marketing ose me kontratë tjetër realizojnë më shumë se 30 % nga të ardhurat e reklamimit, teleshopingut dhe sponsorimit, ndërkaq, nga ana tjetër, pjesë të ndryshimeve ligjore të inkorporuara me Marrëveshjen e Përzhinos, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe deri në përfundimin e tyre, radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) nuk guxojnë të publikojnë reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe të gjithë personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike dhe nëse gjatë prezantimeve publike ose raportimeve publike cenohet të drejtat e disa kandidatëve, të njëjtit kanë të drejtë menjëherë të iniciojnë procedurë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, ku për padi të këtillë gjykata kompetente themelore vendos në afate urgjente, ndërsa vendimi publikohet në mediet publike[12].

### 1.6. Roli i mediave publike në zgjedhjet lokale

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore RTVM e ka për detyrë të transmetojë prezantim politik falas pjesëmarrësve në procesin zgjedhor në përputhje me parimin e balancit, përkatësisht proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë, ndërsa Kanali i Kuvendit duhet të sigurojë prezantim politik falas në kohëzgjatje prej tre orësh edhe për opozitën edhe për partitë në pushtet, në përputhje me rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare, dhe një orë për paraqitësit e listave të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvend, ku

[12] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 42-43.

prezantimi politik falas duhet të shënohet në mënyrë përkatëse dhe të dukshme si "prezantim politik falas" gjatë gjithë kohëzgjatjes së transmetimit ndërkaq, për dallim nga RTVM, radiodifuzerët nuk guxojnë të transmetojnë prezantime politike falas nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre ku nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore ndalohet reklamimi politik falas ndërkaq, nga dita e njëjtë ndalohet edhe publikimi i reklamave të financuara nga buxheti shtetëror dhe komunal dhe në periudhën e njëjtë, radiodifuzerët e kanë për detyrë ta incizojnë programin e tyre, ndërsa incizimet t'i ruajnë më së paku 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, me qëllim që t'ia dërgojnë ASHMAA nëse ajo i kërkon ato, por edhe mediat duhet të përcaktojnë listë të çmimeve për reklamimin politik në afat prej pesë ditësh nga shpallja e zgjedhjeve dhe t'i shpallin publikisht, ndërkaq të njëjtat nuk guxon të ndryshohen gjatë fushatës ndërkaq, radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet mund të transmetojnë më së shumti 18 minuta kohë shtesë për reklamim për orë reale program të transmetuar të dedikuar kryesisht për reklamime politike falas, me ç'rast veçanërisht për partitë politike në pushtet dhe për partitë opozitare parlamentare mund të ndajnë më së shumti nga tetë minuta, ndërsa për partitë parlamentare politike, të cilat nuk kanë grup deputetësh dhe për partitë politike jashtëparlamentare, mund të ndajnë nga një minutë me ç'rast kur ekziston interesim për bashkimin e blloqeve për kohën shtesë për reklamim të një partie politike në dy orë reale të njëpasnjëshme, media duhet të sigurojë një përfaqësim të alternuar të partive politike nga pushteti dhe opozita, në dy orë, ku radiodifuzerët dhe mediat e shkruara e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën e reklamimit të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe për mjetet e paguara ose të cilat duhet të arkëtohen mbi këtë bazë[13].

### 1.7. Mbikëqyrja e zgjedhjeve lokale

Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtë të vëzhgojnë zgjedhjet, ndërsa autorizimin e lëshon KSHZ-ja, ku akreditimin për vëzhgues mund ta marrin organizatat e shoqërisë civile vendase dhe

[13] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 44-46.

të huaja, të cilat janë regjistruar të paktën një vit para zgjedhjeve dhe në statutin e tyre kanë të inkorporuar parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mirëpo duhet thënë se zgjedhjet mund t'i vëzhgojnë edhe përfaqësues të vendeve të huaja dhe përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesin e tyre i cili do të monitorojë punën e organeve zgjedhore[14].

[14] KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar.

## KAPITULLI I DYTË

## HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

### 2.1. Zgjedhjet e para lokale të v. 1996

Zgjedhjet e para lokale në Republikën e pavarur të Maqedonisë u mbajtën në vitin 1996, me dalje mesatare të votuesve për zgjedhjen e këshilltarëve për komunat 60,17%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%, ku dalja mesatare e votuesve për kryetar komune ishte 60,28%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%, ku duhet potencuar faktin që gjatë këtyre zgjedhjeve votimi është anuluar në komuna të caktuara, kështu që në këto të dhëna nuk përfshihen rezultatet e zgjedhjes së kryetarëve të komunave apo anëtarëve të këshillit në gjithsej 9 komuna dhe këto zgjedhje lokale u mbajtën sipas organizimit territorial të vitit 1996, sipas të cilit janë formuar 123 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes locale, ku LSDM-ja fitoi numrin më të madh të vendeve për kryetar komune: 51, VMRO-DPMNE dhe MAAK-konservatore: 27, dhe Partia Socialiste: 19[15].

Që nga periudha e shpalljes së pavarësisë së IRJM qarqet nacionaliste maqedonase ndërtuan sistem të atillë të centralizuar, i cili praktikisht i ç'pushtetizonte shqiptarët. Me këtë sistem shqiptarët edhe në komunat ku ishin shumicë nuk ishin faktorë vendimmarrës për shumë çështje jetësore, si në planin ekonomik, arsimor, kulturor, shëndetësor apo të sigurisë. Ligji për vetëqeversijen lokale, që u miratua në vitin 1995 nuk ishte i përshtatshëm, sepse pushtetin lokal e vendoste në varësi të plotë nga pushteti qendror.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1996, përveç partive maqedonase morën pjesë edhe tre parti politike shqiptare: Partia për Prosperitet Demokratik, Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve dhe Partia Demokratike Popullore, ku lufta kryesore politike në këto zgjedhje u zhvillua

[15] Për më tepër për këto zgjedhje të para lokale të v. 1996 shih në: Државна изборна комисија. Локални избори 1996: Конечни резултати од локалните избори за градоначалници и членови на советите на општините и Градот Скопје. Скопје 1997 година; dhe: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 25.

kryesisht në mes dy krahëve të ish-PPD, Partisë për Prosperitet Demokratik (rryma e vjetër) dhe Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (rryma e re)[16].

Zgjedhjet lokale ishin një sfidë e madhe për popullin shqiptar të Maqedonisë i cili duhej të zgjidhte midis dy opcioneve të mundshme: politikës tradicionale të partisë shqiptare në pushtet, Partisë për Prosperitet Demokratik, ose opsionit reformator të opozitës shqiptare, Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve, që përpiqej të imponojë interesin kombëtar të shqiptarëve në RM, ku edhepse procesi i votimit u manipulua një kohë të gjatë, sidomos në qytetin e Tetovës, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve lokale të vitit 1996 tregoi se populli shqiptar në shumicë dërmuese përkrahu kursin reformator të opozitës shqiptare në RM, me çrast ky kurs reformator (PPDSH), korri fitore në dy qendrat kryesore urbane me shumicë shqiptare, në Tetovë dhe Gostivar, si dhe mori shumicën e Këshillave komunale në nivel të RM, pra, ndër shqiptarët e RM, përmes zgjedhjeve lokale të vitit 1996, u legjitimua një politikë, e cila nga njëra anë e kontestonte politikën e degjeneruar dhe apatike shqiptare dhe njëkohësisht kontestonte proceset shoqërore politike që zhvilloheshin në dëm të interesave kombëtarë të shqiptarëve dhe me t'u vendosur në krye të pushtetit lokal, faktori i ri politik filloi të vë në jetë platformën e tij gjenerale, duke u përpjekur të përmirësojë pozitën e shqiptarëve në sistem, atë që ia mundësonte Ligji për pushtet lokal[17].

Në krye të Ndërmarrjeve Publike që ishin në kompetencë të komunave, për herë të parë u vendosën udhëheqës shqiptarë. Deri në këtë kohë, rolin udhëheqës në ato ndërmarrje e kishin pasur vetëm maqedonas. Hapi tjetër i rëndësishëm ishte përmirësimi i strukturës nacionale të të punësuarve nëpër ato ndërmarrje, që gjithmonë kishte qenë në dëm të shqiptarëve. Çështje mjaft me rëndësi ishte përmirësimi i infrastrukturës komunale, e cila vite me radhë ishte lënë pas dore dhe gjithashtu, duke shfrytëzuar të drejtën kushtetuese të nenit 48 të Kushtetutës[18], në të cilën ngërthehen të drejtat e kombeve që jetojnë në RM për të shprehur veçoritë e tyre etnike, Kuvendi komunal i Tetovës dhe Gostivarit dhe Kuvendet e komunave tjera, ku shqiptarët përbënin shumicën,

---

[16] Partia politike e quajtur "rryma e re" u regjistrua me emrin: Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve – "PPDSH", me Vendimin e sjellur më datë 18. 04. 1995, Slluzhben vesnik na Republika Makedonija, br. 41/94.

[17] Për më tepër në: Zeqirja Rexhepi, *Zgjedhjet lokale në RM-1996*, në dispozicion në linkun: http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/zgjedhjet-lokale-n-i-r-j-m-1996.html.

[18] Vendimi nr. 08-367/4, të datës 2.7.1996, për emërimin e drejtorit të Ndërmarrjes Komunale, Fondit për Udhë Lokale të Komunës së Tetovës dhe NP. "Geoinzhinering", i datës 17. 05. 1997, "Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës", nr. 5/96.

sollën vendim për përdorimin e flamurit kombëtar, i cili u vendos përpara objekteve komunale, krahas simboleve shtetërore të RM[19].

Mirëpo, Gjykata kushtetuese vendosi ndalimin e përkohshëmn të të gjitha simboleve kombëtare shqiptare, me arsyetim se komunat nuk janë kompetente për këtë ku Gjykata kushtetuese obligimin e mëtutjeshëm për zbatimin e vendimit ia la Qeverisë dhe, e tërë kjo gjë, për një kohë të caktuar, mbeti çështje e hapur, mirëpo, Qeveria e priti momentin e përshtatshëm për të intervenuar, me çka u shkaktuan përleshje të mëdha në Gostivar dhe Tetovë në mes popullatës shqiptare dhe forcave policore maqedonase dhe në momentin kur ndodhën këto procese ndodhi edhe një ngjarje me rëndësi të madhe politike, bashkimi i një pjese të faktorit politik shqiptar, të të dy partive politike opozitare, Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe Partisë Demokratike Popullore[20].

### 2.2. Zgjedhjet e dyta lokale të v. 2000

Zgjedhjet e dyta lokale të vitit 2000 kishin një numër të konsiderueshëm shkeljesh të procesit zgjedhor dhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike. Zgjedhjet kishin një sërë incidentesh, dhunë dhe frikësim të votuesve. Në disa komuna: Gostivar, Tetovë, Labunishtë, Xhepçishtë dhe Mavrovi Anovi, zgjedhjet u pasuan me incidente të armatosura. Në disa qendra votimi në komuna të tjera, kutitë e votimit janë hapur dhe shkatërruar me forcë. Në raundin e dytë të votimit u përsërit dhuna në vende të ndryshme. OSBE/ODIHR[21] regjistroi votimin në grup në 25% të qendrave të votimit të vëzhguara, votim të hapur në 8% dhe votim në emër të një tjetri në 5%, dhe pas këtyre zgjedhjeve, KSHZ nuk i publikoi rezultatet e plota dhe gjithëpërfshirëse të zgjedhjeve. Në raundin e parë, koalicioni “Për Maqedoninë së bashku”, i udhëhequr nga LSDM, fitoi 38% të votave për kryetarë komunash, ndërsa koalicioni VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike fituan 27%, PDSH 13% dhe PDP

[19] Për më tepër në: Zeqirja Rexhepi, *Zgjedhjet lokale në RM-1996*, në dispozicion në linkun: http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/zgjedhjet-lokale-n-i-r-j-m-1996.html.
[20] Kushtetuta e RM, Neni 48, thuhet: “Pjestarët e nacionaliteteve kanë të drejtë lirisht të shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë idenitetin dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton mbrojtjen e identitetit nacional, kulturor, gjuhësor dhe fetar…”, Slluzhben vesnik na Republika Makedonija br. 52, 22 noemvri, 1991.
[21] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, 2000.

6%. Rezultatet përfundimtare treguan fitore për koalicionin e VMRO-DPMNE-së dhe Alternativës Demokratike, "Për Ndryshim", në 48% të komunave, gjegjësisht fituan 59 pozita të kryetarëve të komunave, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM "Për Maqedoninë së bashku" fiton 32 pozita të kryetarëve të komunave[22].

## 2.3. Zgjedhjet e treta lokale të v. 2005

Zgjedhjet e treta lokale të 2005 përsëri nuk arritën të përmbushin standardet kryesore ndërkombëtare për universalitetin, barazinë dhe fshehtësinë e votes meqë për dallim nga zgjedhjet e mëparshme, këto zgjedhje nuk u karakterizuan me dhunë, por një sërë parregullsishë janë vërejtur në pjesën perëndimore, veriperëndimore të vendit dhe në Shkup dhe në të njëjtën kohë, zgjedhjet e vitit 2005 janë të parat që janë mbajtur nën organizimin territorial të vitit 2004, i cili themeloi 84 komuna në territorin e Maqedonisë dhe e ruajti statusin e qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes locale ku vëzhguar nga OSBE/ODIHR[23], u konstatuan 30 raste të mbushjes së kutive të votimit dhe mbi 50 raste votimi në emër të një tjetri ndërkaq, në 9 komuna, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, si rezultat i ankesave për parregullsi në rrethin e parë të votimit, është dashur të përsëritet dhe një raund i dytë votimi ishte planifikuar gjithashtu të zhvillohej në këto qendra votimi, duke rezultuar në një raund të dytë, i cili u zhvillua më 10 prill 2005 ku pjesëmarrja e votuesve në raundin e parë ishte 56.36%, në raundin e dytë më 27 mars ishte 53.66%, dhe më 10 prill ishte 35.6% ndërkaq, koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 36 vende për kryetar komune. VMRO-DPMNE dhe koalicioni fituan 21 ulëse për kryetar komune, BDI: 15, VMRO-NP: 3, PDSH: 2 dhe Unioni i Romëve: 1 dhe kryetarë komunash u bënë 7 kandidatë të

---

[22] Për më tepër për këto zgjedhje të dyta lokale të v. 2000 shih në: Државна изборна комисија. Локални избори 2000: Конечни резултати од локалните избори за градоначалници и членови на советите на општините и Градот Скопје. Скопје 2000 година; dhe: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 26.

[23] ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 12 и 27 март и 10 април 2005. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ ОДИХР. Варшава, 2005.

pavarur, përfshirë edhe kandidatin për Shkupin, Trifun Kostovski, i cili u mbështet nga VMRO-DPMNE[24].

Në këto zgjedhje lokale, për herë të parë në nivel lokal si lojtar politik u paraqit edhe BDI, partia e Ali Ahmetit e cila fitoi kryetarë komunash në: Gostivar, Dibër, Strugë, Tetovë, Haraçinë, Bërvenicë, Vrapçishtë, Zajaz, Bogovinjë, Likovë, Oslomej, Tearcë dhe Çair[25].

## 2.4. Zgjedhjet e katërta lokale të v. 2009

Zgjedhjet e katërta lokale të vitit 2009, të mbajtura në të njëjtën ditë me zgjedhjet presidenciale, janë zgjedhjet e para lokale që mbahen në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të OSBE-së për zgjedhje demokratike, mirëpo, megjithatë edhe për këto zgjedhje, OSBE/ODIHR kishte vërejtje të forta për frikësimin e votuesve ku raporti i monitorimit i OSBE/ODIHR vë në dukje frikësimin dhe presionin ndaj votuesve, veçanërisht punonjësve të administratës publike dhe përfituesve të ndihmës sociale, të cilët janë kërcënuar se do të votojnë për partinë në pushtet ku sipas këtij misioni ndërkombëtar u konstatuan: votimi familjar, votimi në emër të një tjetri, i njëjti person duke "ndihmuar" më shumë se një votues, përpjekjet për të ndikuar tek votuesit, frikësimi i votuesve dhe anëtarëve të këshillave zgjedhore, nënshkrimet identike në ekstraktet nga Lista e Zgjedhësve dhe votimi i shumëfishtë dhe ai familjar[26].

VMRO-DPMNE ishte fituese në 56 komuna, BDI në 15, LSDM në 7 dhe PDSH, ND, DPTM, SR, PDMSM fituan nga një kryetar komune. Dy kandidatë të pavarur fituan gjithashtu vende për kryetar komune[27].

Raporti i ODIHR/OSBE bëri pesë rekomandime të tjera prioritare:

-për të ndarë shtetin nga partia;

-të korrigjohen të gjitha mangësitë dhe paqartësitë në Kodin Zgjedhor;

---

[24] Për më tepër për zgjedhjet e treta lokale të v. 2005 shih në: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 26-27.

[25] Për më tepër në: https://portalb.mk/443272-analize-dosje-te-gjitha-zgjedhjet-lokale-ne-maqedoni/.

[26] ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 22 март и 5 април 2009. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ ОДИХР. Варшава, 2009.

[27] Për më tepër për zgjedhjet e katërta lokale të v. 2009 shih në: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 27-28.

-rishikimi dhe korrigjimi i Listës zgjedhore;

-të marrë masa për zgjidhjen e konflikteve të interesit ndërmjet personave të përfshirë në politikë, të cilët ushtrojnë kontroll mbi transmetuesit privatë dhe

-vendosja e afateve brenda të cilave Gjykata do të vendoste për kundërshtimet e Këshillit të Radiodifuzionit[28].

Në të dy raportet, OSBE/ODIHR bëri thirrje për një rishikim të Listës zgjedhore, e cila është një nga rekomandimet që u zbatua. Bashkimi Evropian konsideron se Republika e Maqedonisë ka bërë përparim në mbajtjen e zgjedhjeve dhe rithekson konkluzionet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR. Ambasadori i atëhershëm i SHBA-ve, Philip Reeker, i vlerësoi zgjedhjet si të mira[29].

### 2.5. Zgjedhjet e pesta lokale të v. 2013

Zgjedhjet e pesta lokale të vitit 2013 u zhvilluan në një atmosferë paqësore, duke marrë vlerësime pozitive për efikasitetin e zbatimit të tyre, ndonëse u evidentuan disa mangësi në drejtim të kushteve të pamjaftueshme për të siguruar një fushë të barabartë konkurrimi ndërmjet kandidatëve dhe në këtë kontekst, janë vërejtur dobësi në pjesën e mbivendosjes së aktiviteteve shtetërore dhe partiake, financimin e fushatave zgjedhore, kornizën ligjore, si dhe raportimin mediatik[30]. Megjithatë, në raste të rralla, vërejtjet përfshinin gjithashtu shkelje të fshehtësisë së votimit, votimin familjar dhe shkatërrimin e materialit zgjedhor. Në media u bënë vërejtje serioze kryesisht në drejtim të ndarjes së tyre në vija etnike dhe partiake.

Me këto zgjedhje hyri në fuqi organizimi i ri territorial, i cili për herë të parë zgjodhi kryetarë dhe këshilltarë në 81 komuna, sepse komunës së Kërçovës iu aneksuan komunat Vraneshticë, Drugovë, Zajas dhe Oslomej, ku pjesëmarrja në këto zgjedhje ishte mjaft e lartë meqë në raundin e parë ishte 67%, ndërsa në raundin e dytë që u mbajt në 29 komuna

---

[28] ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 22 март и 5 април 2009. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ ОДИХР. Варшава, 2009.

[29] Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 28.

[30] ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија Локални избори 24 март и 7 април 2013. Набљудувачка мисија за избори на ОБСЕ Конечен извештај. Варшава, 2013.

pjesëmarrja ishte 59% dhe votim të përsëritur ka pasur në komunën e Dollnenit, ndërsa për shkak të rezultateve të anuluara ka pasur rivotim të rrethit të dytë në katër komuna: Qendër, Dollneni, Strugë dhe Gjorçe Petrov dhe pjesëmarrja në ditën e tretë të zgjedhjeve ishte 65%, ku partia politike më dominuese në këto zgjedhje lokale ishte VMRO-DPMNE, e cila fitoi më së shumti kryetarë komunash në krahasim me partitë tjera meqë VMRO-DPMNE fitoi 56 ulëse për kryetar komune, BDI fitoi 14 kryetarë komunash, LSDM fitoi 4, PDSH fitoi 2, Partia Demokratike e Turqve, Partia Progresive Serbe në Maqedoni dhe Bashkimi i Romëve të Maqedonisë fituan nga një kryetar komune si dhe u zgjodhën edhe dy kandidatë të pavarur për kryetarë komunash[31].

[31] Për më tepër për zgjedhjet e pesta lokale të v. 2013 shih në: МОС Т. Финален извештај, Домашно набљудување на локалните избори 2013. Скопје, 2013; dhe: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 28-30.

**KAPITULLI I TRETË**

# ANALIZA LIGJORE DHE PRAKTIKE E ZGJEDHJEVE LOKALE TË TETORIT 2017 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE REZULTATET E TYRE

## 3.1. Përgatitja e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017

Zgjedhjet lokale janë ndër zgjedhjet më të rëndësishme që ju ndihmon popullatës që në një far forme të zgjedhin personat e duhur për ti udhëhequr me komunë ose vendin e tyre aty ku jetojnë. Këto zgjedhje mbahen në çdo 4 vjet përpos në vitin 2017 që për shkaqe politike u shtynë zgjedhjet nga muaji mars në muajin tetor dhe i bien që në ketë periudhë kryetarëve të komunave të ju është zgjatur mandati për 6 muaj më shumë. I gjithë procesi i zgjedhjeve lokale ishte i rregulluar me kushtetutën e viti 1991 të vendit tonë dhe më vonë me kodin zgjedhor të vitit 2006, këto ishin hapat e para për fillimin e përgatitjeve të zgjedhjeve.

Si fillim të përgatitjeve për zgjedhjet mund të konsiderohet ndryshimi në Kodin Zgjedhor në pjesën e nenit 16 ku data e mbajtje së zgjedhjeve nga muaji maj 2017 është zëvendësuar me 15 tetor 2017, ku Kuvendi i miratoi këto ndryshime më 1 qershor të vitit 2017 ndërkaq, Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, në kuadër të kompetencave të tij, më 6 gusht i shpalli zgjedhjet locale, ndërkaq, Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator i miratoi: Angazhimet deklarative për zgjedhje të ndershme dhe demokratike,22 me të cilat, angazhohet për avancimin e procesit zgjedhor dhe për parandalimin e presioneve mbi qytetarët, dhe në këtë Deklaratë Qeveria parashikon formimin e trupit koordinativ, i cili do ta kontrollojë respektimin e ndalimeve të cilat burojnë nga Kodi Zgjedhor në periudhën nga shpallja deri në përfundimin e zgjedhjeve, dhe mes tjerash, theksohet edhe ajo se Qeveria do të publikojë një listë me projekte të filluara të cilat janë aktivitete të rregullta dhe rrjedhëse dhe se të njëjtën do ta kërkojë nga të gjitha komunat dhe nga Qyteti i Shkupit[32].

[32] Angazhime deklarative për zgjedhje të lira dhe të ndershme, Qeveria e RM, Влада на Република Северна Македонија (vlada.mk) dhe Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e

Sipas Kalendarit për zbatimin e zgjedhjeve, pjesëmarrësit në fushatë mund të hapnin llogari të transaksionit nga data 8 gusht 2017 (48 orë pas shpalljes së zgjedhjeve), ndërsa më së voni 48 orë pas verifikimit të Listës së kandidatit, përkatësisht Listës së kandidatëve; llogaritë mbyllen në afat prej 4 muajsh pas përfundimit të zgjedhjeve ndërkaq, qysh para fillimit të fushatës zgjedhore, e cila sipas Kodit Zgjedhor filloi më 25 shtator, partitë më të mëdha filluan të promovojnë një pjesë të kandidatëve të tyre për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë, kështu që, ndër të parët, që më 3 shtator, Arben Taravari ministër i Shëndetësisë, e konfirmoi kandidaturën për kryetar komune nga radhët e Aleancës për Shqiptarët, ndërkaq, LSDM dhe koalicioni më 5 shtator promovuan një pjesë të kandidatëve për kryetarë të komunave të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, koalicioni i VMRO-DPMNE zyrtarisht filloi t'i promovojë kandidatët e vet për kryetarë të komunave më 13 shtator, kur edhe publikoi një pjesë të emrave për komunat e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit; pastaj partitë pjesërisht i publikonin edhe emrat e tjerë të kandidatëve për kryetarë të komunave, VMRO-DPMNE procesin e publikimit të kandidatëve e rrumbullakoi me një Konventë të madhe, e cila u mbajt në Shkup më 23 shtator, në të cilën partia i promovoi të gjithë kandidatët bashkë; Lëvizja BESA kandidatët e vet i promovoi më 24 shtator në Sheshin e Tetovës; BDI, në po atë mbrëmje, i publikoi dhe i prezantoi kandidatët e vet në Konventën e cila u mbajt në Shkup; Aleanca për Shqiptarët ngjarjen promovuese e mbajti më 25 shtator në Tetovë; LSDM kandidatët e vet i prezantoi në disa ngjarje më të vogla në nivel local, ndërkaq, grumbullimi i nënshkrimeve para personave të autorizuar nga KSHZ për propozimin e Listës së kandidatit për kryetar komune, përkatësisht Qytetit të Shkupit dhe lista të kandidatëve për anëtarë të Këshillit komunal, përkatësisht për Këshillin e Qytetit të Shkupit nga grup zgjedhësish, fillon në ditën e 15-të nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjati 15 ditë, ku afati i grumbullimit të nënshkrimeve para KSHZ filloi më 21 gusht, ndërsa përfundoi më 4 shtator 2017, dhe në periudhën kohore nga 21 gushti deri më 9 shtator të vitit 2017, Lista e zgjedhësve ishte në këqyrje publike, me ç'rast çdo qytetar kishte mundësi ta kontrollonte gjendjen e të dhënave të tij[33].

---

Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 17.

[33] kandidati.sec.mk; Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 18. (Lista e zgjedhësve i përfshin të gjithë qytetarët e moshës madhore (mbi 18 vjeç) me vendbanim në territorin

Sipas kalendarit, 23 ditë para ditës së zgjedhjeve, KSHZ duhet t'i publikojë listat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë në vendvotimet e komunave, dhe sipas afateve të përcaktuara ligjore dhe sipas Kalendarit të KSHZ për zbatimin e zgjedhjeve fushata filloi më 25 shtator, ndërsa përfundoi më 13 tetor, ndërkaq për rrethin e dytë fushata përfundoi më 27 tetor të vitit 2017 në mesnatë[34].

### 3.2. Ndryshimet e fundit ligjore përkitazi me zgjedhjet lokale të tetorit 2017

Në vitin 2017 fillimisht u bënë dy ndryshime të Kodit Zgjedhor, edhe atë: e para, ndryshimi i Kodit Zgjedhor u bë për shkak të zhvendosjes së datës së parashikuar për mbajtjen e zgjedhjeve lokale nga muaji maj në muajin tetor, me ç'rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ua vazhdoi mandatin anëtarëve të këshillave dhe kryetarëve të komunave nga zgjedhjet e zhvilluara më 24 mars të vitit 2013 deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj në gjysmën e parë të muajit tetor; e dyta, më 11 shtator të vitit 2017, u miratua ndryshimi i ri i Kodit Zgjedhor sipas së cilit parashikohet se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve[35].

Nga ana tjetër, ndryshimet e tjera të legjislacionit zgjedhor ishin rezultat i Marrëveshjes së Përzhinos, ku në Seancën e 75-të të Kuvendit, me procedurë të shkurtuar, u miratua pakoja e ligjeve, përfshi këtu edhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor që rezultoi nga Marrëveshja e Përzhinos dhe takimi i liderëve, ndërkaq kishin për qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme, kredibile dhe legjitime të parakohshme parlamentare, dhe këto ndryshime kishin të bënin me aspektet në vijim esenciale të procesit zgjedhor lokal:

e Republikës së Maqedonisë të cilët posedojnë dokumente personale biometrike, ku gjithashtu, në Listën e zgjedhësve janë regjistruar shtetas të RM-së të cilët qëndrojnë ose janë me punë të përkohshme jashtë vendit, por posedojnë dokumente të vlefshme të udhëtimit).

[34] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Afati për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e Zgjedhjeve Lokale 2017 për anëtarët e këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët e komunave dhe për kryetarin e Komunës së Qytetit të Shkupit, 7 gusht 2017.

[35] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 67, 1 qershor 2017; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 125/17.

- ndalohet shfrytëzimi i hapësirave të zyrave, pajisjeve dhe automjeteve zyrtare të organeve shtetërore për nevojat e fushatës zgjedhore, përveç me akte të veçanta normative;

- si pjesë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor parashikohet edhe Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike i cili do të nënshkruhet nga partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhje nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, ku me këtë Kodeks, pjesëmarrësit obligohen të mos bëjnë presion mbi të punësuarit në administratën publike dhe shtetërore ose mbi institucione të tjera të financuara nga Buxheti dhe të garantojë se mbështetja, përkatësisht mos-mbështetja e cilësdo parti politike ose kandidati nga ana e qytetarëve, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor nuk do ta shfrytëzojnë si objekt për kërcënim sa i përket vendit të punës ose sigurisë sociale;

- për zgjedhjet lokale të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 5 shtator të vitit 2017 i miratoi Angazhimet deklarative për zgjedhje të lira në të cilat, mes tjerash, u referohet edhe rekomandimeve të Pribes dhe Marrëveshjeve nga Përzhino nga 2 qershori i vitit 2015 dhe nga 20 korriku i vitit 2016, ku në këtë Deklaratë parashikohet formimi i trupit koordinativ, i cili do ta kontrollojë procesin e respektimit konsekuent të Kodit Zgjedhor;

- përbërja e KSHZ u ndryshua, nga 7 anëtarë sa numëronte paraprakisht në 9 anëtarë ku në këtë përbërje bën pjesë kryetari, nënkryetari dhe 7 anëtarë, dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ u ndryshua meqë me ndryshimet e reja, 3 anëtarë propozojnë partitë politike në pushtet, me ç'rast partia në pushtet, me numër më të madh të deputetëve në Kuvend, propozon 2 anëtarë, ndërkaq partia e dytë për nga numri i deputetëve në pushtet propozon 1 anëtar; partitë opozitare propozojnë 3 anëtarë, me ç'rast partia opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend propozon 2 anëtarë, kurse partia opozitare e dyta për nga madhësia për nga numri i deputetëve propozon 1 anëtar; tre anëtarë do të zgjidhen përmes konsensusit, të cilët do ta përfaqësojnë publikun ekspert, dhe me këto ndryshime u inkorporua edhe funksioni Sekretar i Përgjithshëm i KSHZ që ka për qëllim fuqizimin e pjesës administrative;

- ndryshimet plotësuese të Kodit Zgjedhor përfshijnë edhe dispozita që kanë të bëjnë me Listën e zgjedhësve ku KSHZ përcaktohet si institucion i vetëm kompetent për udhëheqjen dhe azhurnimin e Listës së zgjedhësve dhe siguron qasje elektronike deri te Lista e zgjedhësve, në përputhje me aktet normative dhe, e azhurnon Listën e zgjedhësve një herë në muaj, ndërsa në çdo 6 muaj shpall thirrje publike deri te qytetarët për këqyrjen e të dhënave të tyre dhe,

gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të autenticitetit të Listës së zgjedhësve, çdo anëtar i KSHZ mund të kërkojë të bëhet këqyrje në evidencën e MPB për lëshimin e dokumenteve biometrike, si dhe në bazat e të dhënave dhe evidencave të qytetarëve të organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore;

- ndryshimet e Kodit Zgjedhor parashikojnë edhe rritje të procesit të përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e paraqitura për kandidatë për deputetë dhe për anëtarë të këshillit të komunës dhe Qytetit të Shkupit, ku nga 33% parashikohet rritje në 40%, përkatësisht në çdo tre vende më së paku një vend i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese edhe më së paku nga një vend në çdo dhjetë vende[36].

## 3.3.Pjesëmarrësit në zgjedhjet lokale të tetorit 2017

Për 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit gjithsej garuan 223 kandidatë për kryetarë të komunave; të pavarur ose në koalicion, me kandidatë të tyre për kryetarë të komunave morën pjesë 17 subjekte politike, prej të cilave 3 koalicione dhe 14 parti politike: “Koalicioni Për një Maqedoni më të mirë” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët (Uniteti, RDK)”, Bashkimi Demokratik për Integrim, Opsioni Qytetar për Maqedoni, Lëvizja BESA, Lëvizja për Bashkimin Nacional të Turqve, Partia Demokratike Shqiptare, Partia Demokratike e Turqve nga Maqedonia, Levica, Lëvizja Popullore për Maqedoni, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, Lidhja e Romëve nga Maqedonia, Partia Social-demokrate e Maqedonisë, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas, (BPRM); ndërkaq, për anëtarët e këshillave të komunave dhe këshillit të Qytetit të Shkupit gjithsej u paraqitën 373 lista për kandidatë për këshilltarë nga gjithsej 19 subjekte politike[37].

---

[36] KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 196, 10 nëntor 2015; Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, nëntor 2016; Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, 2017, fq. 20-22.

[37] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017, fq. 137-138

### 3.3.1.Partitë politike dhe koalicionet

Partitë politike që janë pjesëmarrës në zgjedhjet e 2017 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë:

1. VMRO -DPMNE
2. Bashkimi Demokratik për Integrim
3. Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
4. Opsioni Qytetarët për Maqedoninë
5. Lëvizja Besa
6. Lëvizja për unitet nacional të Turqve
7. Partia Demokratike Shqiptare
8. Partia Demokratike e turqve në Maqedoni
9. Koalicioni "Aleanca për shqiptarët" (Uniteti, RDK )
10. Levica
11. Lëvizja popullore për Maqedoni
12. Partia për Prosperitet Demokratik
13. Partia politike "Aleanca për shqiptarët
14. Lidhja e romëve të Maqedonisë
15. Partia Social - Demokrate e Maqedonisë
16. Bashkimi i përhershëm radikal maqedonas.

#### 3.1.1.1. VMRO-DPMNE

VMRO-DPMNE është parti që deklarohet si parti popullore në të djathtë të qendrës, me prejardhje ideologjike kristiano-demokrate e cila që nga pavarësia, është njëra nga dy partitë më të mëdha në RMV, duke kandiduar pothuajse në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994, kur e bojkotoi raundin e dytë kështu që, prej themelimit deri në vitin 2003, kryetar i VMRO-DPMNE-së ishte Ljubço Georgievski ndërsa në

kongresin e partisë në maj të vitit 2003, Georgievski e dha dorëheqjen dhe në vend të tij u zgjodh Nikolla Gruevski i cili udhëhoqi me këtë parti politike deri në dhjetor të vitit 2017, kur dha dorëheqje nga posti i tij, që u pranua nga Komiteti Qendror, ndërsa në Kongresin e 16-të të jashtëzakonshëm, të mbajtur në dhjetor 2017, kryetar i partisë u zgjodh Hristijan Mickovski me atë që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, VMRO-DPMNE udhëhoqi koalicionin "Përtëritja e Maqedonisë" dhe fitoi 44 mandate parlamentare[38].

Në zgjedhjet e para lokale të vitit 1996, VMRO-DPMNE bashkë me MAAK-konservatore, fituan 27 komuna; në zgjedhjet e ardhshme lokale të vitit 2000 fitoi 59 vende të kryetarëve të komunave, por në vitin 2005 humbi 37 vende, përkatësisht bashkë me partnerët e Koalicionit dhe mbështetjen e kandidatit të pavarur për Shkupin fitoi 22 vende të kryetarëve të komunave; në zgjedhjet e ardhshme lokale, të mbajtura në vitin 2009 fitoi 56 vende të kryetarëve të komunave dhe bindshëm kthehet në pushtet në nivelin lokal ndërkaq, me rezultatin e zgjedhjeve lokale të vitit 2009, VMRO-DPMNE u imponua si parti dominante në pushtet, në nivel nacional dhe local dhe, në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2013, Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 57 vende të kryetarëve të komunave nga gjithsej 80 komuna, përfshi këtu edhe Qytetin e Shkupit, ku, gjithashtu, fitoi 537 vende të këshilltarëve në 68 komuna[39].

#### 3.1.1.2. Bashkimi Demokratik për Integrim

Bashkimi Demokratik Për Integrim është partia më e madhe shqiptare e cila ka qëndruar në pushtet për një periudhë të gjatë kohore. BDI u themelua nga krahu i luftës gjegjësisht nga ish – pjesëtarët e luftës nga pjesëtarët e UÇK – së e cila u themelua me 5 qershor të vitit 2002 dhe u bë pjesëmarrëse e zgjedhjeve parlamentare.

Kryetar i partisë u zgjodh Ali Ahmeti dhe mbeti i pandryshueshëm deri sot edhe përskaj zgjedhjeve demokratike brenda partiake, si pjesë e pushtetit u bë pjesë në "koalicionin e parë qeveritar BDI-ja e pati me LSDM-në vitin 2002, ndërsa nga korriku i vitit 2008 krijoi koalicionin qeveritar me VMRO-DPMNE-në i cili zgjati tetë vjet deri në fund të dhjetorit të vitit 2016. Kjo

---

[38] Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të VMRO-DPMNE-së: https://www.vmro-dpmne.org.mk/.

[39] Jane Dimeski; Marko Pankovski; Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, 2017, fq. 50-51.

forcë politike gjithashtu ka fituar edhe në referendumin për ndarjen territoriale në vitin 2004, zgjedhjet lokale të vitit 2005, zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008, zgjedhjet lokale dhe presidenciale më 2009, zgjedhjet e hershme parlamentare më 2011, përsëri ato të parakohshmet në 2014 gjer në zgjedhjet e fundit në dhjetor të vitit 2016, ku krijoi koalicionin qeveritar me LSDM-në e cila tani është në pushtet.

Në këto vite të ekzistimit të saj, pas kuvendit themelues, BDI ka organizuar katër kongrese, nga të cilët i pari më 19 nëntor 2005, i dyti më 19 dhjetor 2009, i treti në përvjetorin e partisë më 5 qershor të vitit 2014 dhe kongresi i katërt është ai dyditor tematik në mars të vitit 2015[40].

Nga themeli i saj deri më sot partia në fjalë ka marr pjesë në disa cikla zgjedhor lokale, BDI ka marrë pjesë në dy cikle zgjedhore për pushtetin lokal; edhe në zgjedhjet e vitit 2005 edhe në ato të vitit 2009, BDI fitoi 15 vende të kryetarëve të komunave, por në vitin 2009 e humbi Tetovën dhe Gostivarin, komuna këto me shumicë të popullsisë etnike shqiptare; pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013, BDI ka 14 kryetarë të komunave nga gjithsej 80 komuna dhe qyteti i Shkupit, BDI në zgjedhjet lokale do të garoj si parti e pavarur me kandidatë të vet në 18 komuna, ndërsa në Manastir, Gazi Babë dhe Ohër do të dalin me lista të përbashkëta të këshilltarëve me BESA dhe Aleancën për Shqiptarët[41].

Bashkimi Demokratik për Integrim doli nga ish-anëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila nisi një konflikt të armatosur në v. 2001 dhe ideologjikisht, deklarohet si parti e qendrës së majtë që mbron të drejta më të mëdha të shqiptarëve dhe zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me çrast kjo parti politike u formua në vitin 2002 dhe mori pjesë në zgjedhjet parlamentare për herë të parë në të njëjtin vit, duke fituar numrin më të madh të votave në mesin e elektoratit etnik shqiptar, duke siguruar gjithsej 16 mandate parlamentare dhe duke u bërë pjesë e qeverisë së udhëhequr nga LSDM, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, BDI shënoi një rezultat dukshëm më të ulët, duke fituar vetëm 10 deputetë, pjesërisht për

---

[40] https://www.botasot.info/maqedonia/1098887/foto-e-rralle-nga-themelimi-i-partise-bdi/ e marr me datë 01.02/2023

[41] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.53

shkak të rritjes së Aleancës së Shqiptarëve dhe BESA, mirëpo, në koalicion me LSDM-në, BDI ishte sërish pjesë e Qeverisë[42].

Ali Ahmeti është kryetar i partisë që nga themelimi i saj me atë që, në nivel lokal në zgjedhjet lokale të vitit 2017, BDI kishte 10 kryetarë komunash nga gjithsej 80 komuna dhe nga qyteti i Shkupit, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020, BDI fitoi 15 mandate, e cila pas negociatave paszgjedhore me LSDM-në përsëri e formoi shumicën parlamentare duke u bërë pjesë e qeverisë, ndërkaq, në qershor të vitit 2021, në festën e 19-vjetorit të BDI-së, partia njoftoi se do të vendosë një agjendë të gjelbër dhe do të fokusohet në ruajtjen e mjedisit jetësor kurse në zgjedhjet lokale të vitit 2021, BDI garoi me kandidatë për kryetarë komunash në 19 komuna dhe lista për këshilltarë në 34 komuna, ndërsa në komunën e Çashkës garoi së bashku me Aleancën për Shqiptarët[43].

#### 3.1.1.3. Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

Lidhja socialdemokratike e Maqedonisë u themelua me 3 Qershor të vitit 1900 në fshatin Zhitosh – Krushevë si parti majtiste e cila kishte rrënjët edhe në organizatën revolucionare maqedonase[44] të cilët kishin për qëllim idenë e përparimit dhe lirive në një shtete të pavarur duke u çliruar nga ndikimi i jashtëm; Ideja socialdemokrate është më dominuesja në Luftën e Dytë Botërore përmes Partisë Komuniste të Maqedonisë, rezultati është seanca e parë e ASNOM-it më 2 gusht 1944, e cila paraqet fillimin e formimit të shtetit dhe aspirata shekullore për pavarësi dhe liri të qytetarëve në Maqedoni, tani Republika e Maqedonisë së Veriut, është arritur[45].

Këto ide të tyre kanë qenë aspiratat kryesore të udhëheqësve dhe të vetë partisë, si pjesë e shtetit tonë edhe LSDM ka marrë pjesë në gjitha ciklat zgjedhor qofshin ato parlamentare, lokale apo për kryetar të shtetit; vetë LSDM është bartëse e Qeverisë së parë politike të Republikës së Maqedonisë, tani Republika e Maqedonisë së Veriut, e zgjedhur më 4 shtator 1992; kryeministër është kryetari i LSDM-së, Branko Cërvenkovski, kjo Qeveri ka një rol të rëndësishëm

[42] Për më tepër hih në ueb faqen e BDI-së: https://bdi.mk/.
[43] Po aty.
[44] https://sdsm.org.mk/sdsm/istorija e marr me datë 02.02.2023
[45] Po aty e marr me datë 02.02.2023

në ruajtjen e stabilitetit të shtetit në vitet e para të pavarësisë, në një gjendje embargoje, sanksionesh dhe izolimi ndërkombëtar[46].

Kryetarët e kësaj partie kanë qenë disa, nga themeli deri në vitin 2004 ka qenë Branko Crvenkovski, nga vitit 2004 deri në vitin 2006 ka qenë Vllado Buçkovski, nga viti 2006 e deri në vitin 2008 ka qenë Radmilla Shekerinska, pastaj në vitin 2009 – 2013 rikthehet Branko Cërvenkovski, dhe nga 2013 zgjidhet kryetar i kësj partie Zoran Zaev deri në vitin 2021 kur jep dorëheqje, më pas zgjidhet Dimitar Kovaçevski, pra partia brenda saj për zgjedhje të kryetarëve ka pas një sistem demokratik.

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me origjinë ideologjike socialdemokrate, e cila u themelua në Kongresin e 21 prillit 1991, si trashëgimtare ligjore e Bashkimit të Komunistëve të Maqedonisë - Partia për Transformim Demokratik (SKMDPD), ndërkaq, në të njëjtin vit partia e ndryshoi emrin e saj në LSDM dhe ideologjinë e saj nga komuniste në socialdemokrate duke marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale që nga pavarësia e RMV-së, ku në zgjedhjet e fundit të parakohshme parlamentare të vitit 2020, LSDM dhe partnerët e saj të koalicionit fituan gjithsej 46 ulëse dhe në negociatat paszgjedhore me BDi-në dhe PDSH-në arritën ta formojnë shumicën parlamentare dhe të formojnë qeverinë[47].

#### 3.1.1.4. Opsioni qytetar për Maqedoni

Partia Opsioni qytetar për Maqedoni është parti e formuar nga z. Stevço Jakimovski, ku iu dha një mundësi qytetarëve për zgjedhjen e një opsioni të ri politik duke pasur parasysh edhe dallimet të cilat i kishte nga partitë e tjera politike, partia themelohet në vitin 2014 dhe merr pjesë në zgjedhjet parlamentare si e pavarur ku fiton një deputet, kurse në vitin 2016 merr pjesë si pjesë e koalicionit të VMRO-DPMNE, kurse në vitin 2017 do garojë si parti e pavarur në zgjedhjet lokale[48].

---

[46] Po aty, e marr me datë 02.02.2023

[47] Për më tepër shih në ueb faqen e LSDM-së: https://sdsm.org.mk/.

[48] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.57

#### 3.1.1.5. Lëvizja Besa

Lëvizja BESA është lëvizja më e re politike e cila në u themelua me 23 Mars të vitit 2015 në Shkup, ku për kryetar të partisë u zgjodh Bilall Kasami nga Tetova, si parti e re apo lëvizje e re që doli kishte shfaqur interesin për mbrojtjen e shqiptarëve dhe interesave të tyre, për ardhjen e kohës së ndryshimeve apo thënë ndryshe lëvizja si pikënisje e kishte organizimin asimetrik të shtetit ndaj popujve të vet, ku në vend të asimetrisë, shteti duhet të bazohet mbi parimet e lirisë, barazisë, drejtësisë, mirëqenies, luftës kundër korrupsionit[49].

Lëvizja BESA si subjekt politik përshkruhet me tre A:

- "AUTENTIKE sepse buron nga nevojat reale të shqiptarëve në Maqedoni;
- AUTOKTONE sepse është krijuar nga kapacitetet vendore shqiptare në Maqedoni;
- AUTONOME sepse është e hapur për bashkëpunim me të gjithë, ajo është lëvizje e pavarur, subjekt në vete dhe e pavarur nga çdo subjekt i brendshëm apo i jashtëm[50].

Lëvizja Besa qëndroi besnike ndaj popullit në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 dhe vetëm se në zgjedhjet lokale të vitit 2017 filluan përçarjet në mes partisë, të cilat më pas do ndjekjen deri në ndarjen e vetë partisë në dy subjekte të ndryshme, por në fillim të Lëvizën Besën e mbartin të dy partitë deri sa procesi u zgjedh nëpërmjet gjyqësorit që Lëvizja Besa është e Bilall Kasamit kurse pjesa tjetër u detyrua që të hapin subjektin politik të ri të quajtur Alternativa.

Partia politike Lëvizja BESA është themeluar më 23 mars 2015 në Shkup me kryetar Bilall Kasami dhe synon të promovojë interesat e të gjithë qytetarëve, veçanërisht të shqiptarëve, ku angazhimet bazë kanë të bëjnë me: barazinë, drejtësinë, lirinë dhe prosperitetin, me çrast, Lëvizja Besa nis nga pozicioni asimetrik i shtetit ndaj popujve në të dhe në vend të asimetrisë, shteti duhet të bazohet në: parimet e lirisë, barazisë, drejtësisë, prosperitetit, luftës kundër korrupsionit dhe për arritjen e këtyre synimeve, Lëvizja Besa përpiqet të ndryshojë funksionimin e sistemit në vend, të zhvillojë vlerat universale të humanizmit, të përmirësojë demokracinë në

[49] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.57 – 58.

[50] https://portalb.mk/wp-content/uploads/2018/01/STATUT_Levizja-BESA_27.12.2014_fund.pdf e marr me datë 02.03.2023

vend, të eliminojë të gjitha format e diskriminimit dhe të ndërtojë shtetin ligjor, ndërsa kjo parti mori pjesë për herë të parë në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, ku fitoi gjithsej 5 deputetë, (4,86% e votave në shkallë vendi) kurse në zgjedhjet e kaluara parlamentare të vitit 2020, Besa ka marrë pjesë në koalicionin "Mundemi" të udhëhequr nga LSDM, i cili ishte koalicioni i parë parazgjedhor ndërmjet partive politike nga blloku maqedonas dhe shqiptarë[51].

#### 3.1.1.6. Lëvizja për unitet nacional të turqve

Lëvizja për unitet nacional të turqve është lëvizje partiake e cila mbron të drejtat e pakicave gjegjësisht të drejtat e turqve, kryetar i kësaj lëvizje është Erdogan Saraç e cila për herë të parë ka marr pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006[52]. Gjatë një periudhe të gjatë kjo lëvizje nuk ka arrit ndonjë sukses në raundet zgjedhore, më pas ajo ka bërë disa koalicione herë me LSDM e kohë pas kohe edhe me VMRO – DPMNE dhe në koalicionin e fundit me VMRO – DPMNE ka fituar 9 vende të këshilltarëve në Dibër, Qendër së Zhupës dhe në Shuto Orizare[53].

#### 3.1.1.7. Partia Demokratike Shqiptare

Partia Demokratike Shqiptare është partia e dytë e cila që nga vitet e hershme është pjesë e pushtetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kjo parti u formua si rrjedh e PPD-së, e cila si PPDSH fitoi legjitimitetin e saj nga vitit 1995 ku paraqiti mbrojtjen e interesave kombëtare të shqiptarëve në IRJM, paraqiti propozim – projektin e saj për rregullimin e Kushtetutës së IRJM dhe përshtatjen e saj sipas realitetit politik dhe historik të popujve që jetojnë në këtë republikë[54].

---

[51] Për më tepër shih në ueb faqen e Lëvizjes Besa: https://www.levizjabesa.mk/.

[52] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.58.

[53] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.59.

[54] http://partiademokratikeshqiptare.blogspot.com/2008/01/partia-pr-prosperitet-demokratik-e.html e marr me datë 03.02.2023

Në vitin 1994 kur u themelua PPDSH – ja kryetar i saj u zgjodh Arbër Xhaferi i cili do ta udhëheq në këtë post për një kohë të gjatë duke u bërë edhe pjesë e shumë ndryshimeve historike të cilat do jenë në vazhdimësinë e karrierës së tyre politike; në vitin 2001 do jetë pjesë e Marrëveshjes së Ohrit pas konfliktit të 2001, ku nënshkruhet nga Arbër Xhaferi dhe më pas në zgjedhjet parlamentare do jetë pjesë e opozitës për tu rikthyer edhe njëherë si pozitë për dy vite dhe prej vitit 2008 do jetë pjesë e opozitës dhe në çdo zgjedhje numri i mandateve ose kryetarëve dhe këshilltarëve komunal do jetë në rënie, ndërkaq, në vitin 2007 PDSH -ja do ketë një ndryshim, ku në kongresin e mbajtur atëherë për kryetar partie do të zgjidhet Menduh Thaçi me 30 Qershor 2007[55].

Në zgjedhjet lokale të vitit 2005 PDSH do të bashkohet me PPD ku do të fitojë dy komuna për ti udhëhequr, në vitin 2009 do të fitojë vetëm komunën e Tetovës, kurse në vititn 2013 do të fitojë komunën e Strugës në krye me Ziadin Selën, i cili më pas do ndahet nga PDSH- ja duke krijua LR-PDSH[56].

#### 3.1.1.8. Koalicioni “Aleanca për shqiptarët” (Uniteti, RDK)

Në 27 Mars të vitit 2011, Rufi Osmani promovoi Partin e tij të quajtur Rilindja Demokratike Kombëtare duke ofruar edhe plan programin e partisë e cila ishte me rëndësi të madhe për ta shfaqur para opinionit, pikat kyçe të platformës politike të RDK-së ishin: avancimi i statusit të shqiptarëve si popull shtet formues në Maqedoni, parimi i konsensusit politik, zyrtarizimi i gjuhës shqipe në gjitha nivelet nacionale, ndarja proporcionale e buxhetit të shtetit në investimet kapitale, etj[57].

Rufi Osmani si kryetar i partisë ishte deri në vitin 2014, kur edhe i humbi zgjedhjet dhe dha dorëheqje nga ky post, kurse në krye të partisë më vonë do zgjidhet Vesel Memedi; para

---

[55] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.60.

[56] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.60

[57] https://cssd-ngo.org/kronologji-e-shkurter-e-partive-politike-shqiptare-te-maqedonise-veriore-1990-2020/ e marr me datë 04.02.2023

zgjedhjeve parlamentare të 2016, filluan probleme edhe në këtë parti, më 13 mars 2016, u mbajtën dy mbledhje paralele edhe atë në zyrat e RDK-së në Gostivar zhvillonte mbledhjen Vesel Memedi me përkrahësit e tij, ndërsa kryesia e RDK zhvillonte mbledhje të Kuvendit qendror në Tetovë ku shkarkohet Vesel Memedi dhe në vend të tij emërohet si kryetar i RKD-së Fadil Zendeli, pas vendimit të gjyqit se kryetar legal dhe legjitim i RDK-së është Vesel Memedi, grupi i Fadil Zendelit në zgjedhjet e 2016 bashkë me Lëvizjen Besa formuan koalicionin "Rilindje me Besë", ndërsa RDK e Vesel Memedit u bë pjesë e koalicionit "Aleanca për Shqiptarët", bashkë me LR-PDSH dhe UNITETIN[58].

Uniteti është parti e formuar nga anëtarë të BDI të cilët u ndan nga kjo parti duke formuar kështu parti të re të quajtur Uniteti, ku për kryetar të partisë zgjidhet Gëzim Ostreni dhe i cili në vitin 2016 do garojë me listë të përbashkët me partitë e lartpërmendura por nuk arrin të fitojë asnjë deputet.

Aleanca për Shqiptarët është një parti politike që buron nga Lëvizja për Reforma në Partinë Demokratike të Shqiptarëve, që drejtohet nga Zijadin Sela dhe synimi kryesor i Aleancës për Shqiptarët është barazia e plotë mes shqiptarëve dhe maqedonasve në të gjitha fushat, si: investimet, përfaqësimi institucional, aksesi i drejtë në institucionet shtetërore, punësimi, infrastruktura dhe ngritja e vetëdijes kombëtare, ku në zgjedhjet lokale të vitit 2017, më pas si Aleancë e Koalicionit të Shqiptarëve kandidoi në komunën Gostivar dhe Dibër, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, Aleanca për Shqiptarët dhe koalicioni Alternativa fituan 12 mandate kurse në zgjedhjet lokale të v. 2021 ASH ishte në koalicion me partinë politike Alternativa me gjithsej 15 kandidatë për kryetarë komunash dhe poashtu, në këto zgjedhje lokale ASH-A shpallën edhe koalicion parazgjedhor me VMRO-DPMNE me fokus në Qytetin e Shkupit[59].

### 3.1.1.9. Partia për Prosperitet Demokratik

Partia për Prosperitet Demokratik është partia e parë shqiptare e formuar në vitin 1990 me ndarjen e Maqedonisë së Veriut nga Jugosllavia, dhe e cila do të luftonte për herë të parë

[58] Po aty, e marr me datë 04.02.2023

[59] Për më tepër shih në ueb faqen e ASH-së: https://aleanca.mk/.

nëpërmjet rrugëve institucionale për ti arritur të drejtat dhe liritë themelore të shqiptarëve brenda shtetit të Maqedonisë së Veriut.

PPD u formua me 15 Prill 1990 ndërsa u regjistrua me 25 Maj 1990 kurse kryetar i saj u zgjodh Nevzat Halili i cili në këtë post qëndroi për 4 vite dhe më pas u shkarkua në vitin 1994, dhe si kryetar i PPD së zgjidhet Abdurrahman Alili i cili do të qëndrojë në këtë post deri në vitin 2000[60].

Me largim të Abdurrahman Halitit, në krye të Partisë për Prosperitet Demokratik në vitin 2000 zgjidhet Imer Imeri, i cili në vitin 1993 ka qenë zëvendësministër i Shëndetësisë në Qeverinë LSDM-PPD, në vitin 2001, në cilësinë e kryetarit të PPD-së, Imer Imeri ka qenë një nga nënshkruesit e Marrëveshjes së Ohrit, bashkë me kryetarin e ndjerë të PDSh-së, Arbën Xhaferi dhe përfaqësuesin e atëhershëm të UÇK-së, Ali Ahmeti[61].

Përpos emrave të lartpërmendur PPD ka pasur edhe një numër tjetër të emrave për kryetar të partisë të cilët i ka ndryshuar sikurse që janë:

Abdulmenaf Bexheti – Një vit e gjysmë.

Abdyladi Veseli - për 5 vite

Sefedin Haruni – Për dy vite , kurse mbas tij janë përfolur dhe janë thirrur në emër të PPD – së edhe një grup emrash sikurse që ishin: Arben Rusi, Jeton Xheladini, Nexhat Bexheti, Esat Asllani, Faton Aliti, ndërkaq, në gusht të 2017 në Kongresin e shtatë të jashtëzakonshëm të PPD-së, rreth 700 delegatë të Partisë për Prosperitet Demokratik zgjodhën Abdyladi Veselin kryetar të PPD-së[62].

#### 3.1.1.10. Levica

Partia Politike Levica u themelua në fund të vitit 2015, e cila sipas statutit, ka një ideologji të fortë majtiste dhe mbron vlerat e majta, duke përfshirë antikapitalizmin, anti-nacionalizmin, anti-militarizmin, anti-klerikalizmin dhe anti-konservatorizmin, me çrast fokusi i partisë është te të drejtat e punëtorëve dhe ato elementare të njeriut dhe si parti ajo qëndron mbi të gjitha për

---

[60] https://cssd-ngo.org/kronologji-e-shkurter-e-partive-politike-shqiptare-te-maqedonise-veriore-1990-2020/ e marr me datë 05.02.2023

[61] Po aty, e marr me datë 05.02.2023

[62] Po aty e marr me datë 05.02.2023

të varfrit, të paprivilegjuarit, të margjinalizuarit dhe të shtypurit, kështu që, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 partia ka garuar e vetme, duke fituar 12.120 vota (1,02%), ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të v. 2020, partia doli në vendin e pestë për nga numri i votave të fituara, ku për listat e kandidatëve të kësaj partie votuan 37.426 votues, që përbën 4,1% të numrit të përgjithshëm të votave, duke fituar kështu 2 mandate parlamentare dhe për herë të parë i ka deputetët e saj në Kuvend[63]. Iniciativa për formimin e Levicës erdhi nga anëtarë të Lëvizjes për Drejtësi Sociale "Lenka", anëtarë të Lëvizjes së majtë "Solidariteti", anëtarë të Partisë Komuniste të Maqedonisë, sindikatave, veprimtarë dhe individë të majtë ku deri në vitin 2019, Partia Levica kishte një kryesi kolektive: Presidiumin, i përbërë nga shtatë anëtarë me mandat imperative ndërkaq, në seancën e rregullt të Plenumit të partisë politike miratohet statuti i ri i partisë, i cili ndryshoi strukturën organizative, ku përveç organeve bazë drejtuese: Plenumi, Komiteti Qendror, Presidiumi dhe Tribunali, prezantohet edhe pozita e kryetarit për një mandat katër vjeçar, ku presidenti aktual i partië politike Levica është Dr. Dimitar Apasiev[64].

### 3.2. Fushata zgjedhore e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017 dhe financimi i saj

Fushata zgjedhore  në zgjedhjet lokale ose në çfarë do zgjedhje paraqet prezantimin publik të kandidatëve për kryetar komune ose të këshilltarëve të saj, ku këto prezantime bëhen nëpërmjet takimeve publike, ngjarjeve, ngjitjes së afisheve, video-prezantimeve publike, shpërndarjes së materialeve të printuara dhe prezantimit në media dhe fushata zgjedhore fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve, pra një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve nuk lejohet fushatë zgjedhore dhe transmetim i saj[65].

Fushata zgjedhore në vititn 2017 për zgjedhje lokale në rrethin e parë filloi me 25.09.2017 dhe zgjati deri me 13.10.2017, kurse në rrethin e dytë filloi me 15.10.2017 deri me 27.10.2017. Sipas Misionit monitorues të OSBE/ODIHR, gjatë fushatës zgjedhore partitë kishin mundësi lirisht t’i zhvillojnë fushatat e tyre, me ç’rast u respektua liria e bashkimit, tubimit dhe liria e të

[63] Për më tepër shih në ueb faqen e Levica: https://levica.mk/.
[64] Po aty.
[65]  OSBE -  Çfarë është pushteti lokale dhe si e zgjedhim atë, Doracak për zgjedhje lokale i dedikuar për votues, f.18

shprehurit, por, megjithatë, Misioni pas rrethit të parë nënvizoi se ekzistojnë të dhëna kredibile për blerjen e votave, presion mbi votuesit dhe raste të izoluara të dhunës që ndodhën në periudhën parazgjedhore; mediat e monitoruara ofruan mbulim të paanshëm të garuesve dhe e mbështetën mundësinë për debat politik, edhe pse u vërejtën disa parregullsi procedurale, dita zgjedhore kryesisht kaloi në rregull, u prononcuan vëzhguesit[66].

Në zgjedhjet lokale të vitit 2017 ka pasur lajmërime të caktuara ku janë ankuar qoftë kandidatë të ndryshëm për komuna qoftë edhe këshilltarët, pra ka pasur incidente të kohë pas kohe, për të cilat gishti iu është drejtuar fushatave zgjedhore për zgjedhje lokale.

Në fushatat zgjedhore kanë pasur edhe debate televizive të organizuar për kandidatët e paraqitur në nivel komunal, ku kanë prezantuar programet e tyre për të ardhmen e komunës, por ka pasur edhe raste kur kanë refuzuar pjesëmarrjen në këto debate me arsyetim se televizioni është mbështetës i njërës apo tjetrës parti.

Çdo parti dhe çdo koalicion ka pasur sloganin e tij me çka është paraqitur para popullit, kështu që:

"Koalicioni LSDM kishte sloganin: Jetë për të gjithë në Maqedoni;

Koalicioni VMRO – DPMNE: Fillon epoka e re dhe Gjithmonë punë,gjithmonë Maqedoni;

BDI: Për komunën që e duam;

Lëvizja Besa: Për një jetë të re;

Aleanca për shqiptarët: Me dije dhe guxim[67].

Këto ishin sloganet nga partitë më të mëdha të cilët garuan në zgjedhjet lokale të vitit 2017 ku nuk duhet harruar që edhe përskaj këtyre sloganeve kohë pas kohe u merrnin edhe me oponentët kundërshtar duke akuzuar për padrejtësi, korrupsion, etj.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2017 nga raportet e ndryshme që janë paraqitur në Entin Shtetërore për Statistika për rrethin e parë të zgjedhjeve dhe rrethin e dytë të zgjedhjeve në këto zgjedhje lokale janë paraqitur.

---

[66] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.140

[67] Po aty, f.142 – 143.

**TABELA 2[68]:**

**Të ardhurat dhe shpenzimet e zgjedhjeve lokale nga partitë politike**

| | ***Partia Politike*** | ***Të ardhura*** | ***Shpenzime*** | ***Saldo*** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | VMRO – DPMNE | 33.058.102 | 69.989.757 | - 36.931.665 |
| 2. | LSDM | 52.765.931 | 31.203.177 | - 21.562.745 |
| 3. | BDI | 9.962.500 | 21.303.915 | - 11.314.415 |
| 4. | PDSH | 626.000 | 730.855 | - 104.855 |
| 5. | BESA | 4.579.610 | 7.081.719 | - 2.502.109 |
| 6. | LEVICA | 119.908 | 281.114 | - 161.206 |
| 7. | Aleanca për Shqiptarët | 2.362.570 | 1.366.272 | 996.298 |
| 8. | Koalicioni Aleanca për Shqiptarët | 1.267.500 | 1.265.930 | 1.570 |
| 9. | OPQM | 1.873.480 | 1.803.809 | 69671 |
| | Gjithsej në Denarë | 106.615.601 | 135.026.558 | -28.410.057 |
| | Gjithsej në Euro | 1.733.587 | 2.195.553 | -461.966 |

Duke e parë tabelën mund të themi se partitë të cilat kanë paraqitur pjesëmarrje në zgjedhje kanë pasur edhe të siguruar pjesë financiare të saj, por partitë qoftë në bllokun maqedonas e qoftë edhe ai shqiptarë kanë harxhuar një shumë shumë më të madhe nga mundësia ose fondi financiar që kanë pasur; pra partitë sikurse LSDM, VMRO- DPMNE, BDI, PDSH dhe BESA, kanë pasur një buxhet të lartë në fondin e tyre por harxhimet të cilat i kanë bërër për fushatën zgjedhore nuk ju kanë mjaftuar vetëm se fondin që e kanë pasur por janë futur në harxhime më të mëdha, kurse partia Aleanca për Shqiptarët, Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe OPQM janë parti që nuk e kanë tejkaluar fondin e tyre, kurse Aleanca për shqiptarët është partia e cila ka harxhuar më së paku në këto zgjedhje duke e kursyer fondin e tyre.

[68] Të dhëna nga Enti Shtetëror për Statistikë.

### 3.3. Rezultatet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017

Në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, i cili u mbajt më 15 tetor të vitit 2017, në votim dolën gjithsej 1.079.876 nga gjithsej 1.814.644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve, me çka dalja në rrethin e parë ishte 59,51%, ndërkaq, në rrethin e dytë të zgjedhjeve, dalja u zvogëlua dhe ishte 51,92%, dhe në krahasim me zgjedhjet e kaluara lokale nga muaji mars i vitit 2013 dalja në rrethin e parë ishte 66,81% dhe në rrethin e dytë 64,9% por, dalja në këto zgjedhje lokale gjithashtu ishte më e ulët edhe nga dalja në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën më 11 dhjetor të vitit 2016 e cila ishte 66,79%[69].

Në rrethin e parë, për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit për fletëvotime të pavlefshme u shpallën gjithsej 57.023 (4,3%) ku, nga fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, si të pavlefshme u shpallën gjithsej 65.048 fletëvotime (5%), ndërkaq, për 80 komuna dhe për Qytetin e Shkupit garuan gjithsej 223 kandidatë për kryetarë të komunave, dhe në mënyrë të pavarur ose në koalicion me kandidatë të tyre për kryetarë të komunave morën pjesë 17 subjekte politike prej të cilave 3 koalicione dhe 14 parti politike[70].

Në rrethin e parë të zgjedhjeve u zgjodhën kryetarët e 45 komunave dhe të Qytetit të Shkupit ndërkaq, në rrethin e dytë të zgjedhjeve u votua për kryetarët e 35 komunave, ndërsa rivotim, përkatësisht rreth të tretë, kishte vetëm në Komunën e Çairit në një vendvotim që u mbajt më 12 nëntor; në dy rrethet, numër më të madh të vendeve të kryetarëve të komunave fitoi LSDM në 57 komuna dhe në Qytetin e Shkupit; VMRO-DPMNE fitoi 5 vende të kryetarëve të komunave, BDI 9, Partia Politike "Aleanca për Shqiptarët"-3 vende, ndërsa nga një kryetar komune fituan BESA, PDSH dhe PDT, ndërsa 3 vende të kryetarëve të komunave i fituan kandidatët e pavarur, ndërkaq, pas rivotimit më 12 nëntor BDI fitoi edhe një vend të kryetarit të komunës, me çka kjo parti në këto zgjedhje fitoi gjithsej 10 vende të kryetarëve të komunave[71].

---

[69] Ueb Faqeja e KSHZ, Zgjedhjet lokale 2017, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2017/.
[70] Ibid.
[71] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë për rezultatet e sublimuara nga votimi sipas komunave, 30.10.2017, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2017/.

Për zgjedhjen e këshilltarëve të komunave LSDM fitoi 422.522 vota (39,1%); VMRO-DPMNE fitoi 335.769 vota (31%), BDI fitoi 89.724 vota (8,3%), Partia Politike “Aleanca për Shqiptarët” 49.125 (4,5%), BESA 46.493 (4,3%), PDSH 16.865 (1,56%), PDT 10.239 (0,9%) dhe LPM 4.506 (0,4%) vota, dhe rrjedhimisht me këtë gjë, LSDM fitoi gjithsej 552 vende të këshilltarëve, VMRO-DPMNE: 432; BDI: 127; BESA:63; Partia Aleanca për Shqiptarët:63; PDSH: 23; PDT: 17; LPM dhe LRM nga 7 këshilltarë, Koalicioni i përbërë nga BDI, Aleanca për Shqiptarët dhe BESA në Manastir, Gazi Babë dhe Ohër fitoi gjithsej 4 këshilltarë në të tri komunat, OPQM, LBNT dhe LEVICA fituan nga tre këshilltarë; nga dy këshilltarë fitoi Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Koalicioni Për Ardhmëri më të Mirë i udhëhequr nga Femih Bejllurov, ndërsa PPD fitoi një këshilltar[72].

### 3.3.1. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave në RMV

**TABELA 3[73]:**

**Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave**

| Nr. | Komuna | Kandidati | Partia Politike | Fituesi i zgjedhjeve |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Aerodrom | Ivica Konefski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO – DPMNE | |
| | | Zllatko Marin | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zllatko Marin |
| 2. | Haraçinë | Isuf Bislimi | BDI | |
| | | Ali Ismail | Lëvizja BESA | |
| | | Milikije Halimi | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Milikije Halimi |
| | | Isen Ramadani | Partia politike Aleanca për shqiptarët | |
| 3. | Berovë | Nikolla Atanasov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Zvonko Pekevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zvonko Pekevski |
| 4. | Manastir | Zoran Ilievski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Natasha Petrovska | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Natasha Petrovska |
| | | Jorgo Ognenovski | Kandidat i pavarur | |
| | | Qirço Tashkov | Kandidat i pavarur | |

[72] Ibid.
[73] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë për rezultatet e sublimuara nga votimi sipas komunave, 30.10.2017, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2017/.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5.** | Bogdancë | Nikolla Roglev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Bllazhe Shipov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Bllazhe Shipov |
| **6.** | Bogovinë | Minur Asani | Lëvizja Besa | |
| | | Berzah Bejtullahu | BDI | |
| | | Elvir Iseni | PDSH | |
| | | Albon Xhemaili | Partia politike Aleanca për shqiptarët | Albon Xhemaili |
| | | Vebi Xhemaili | PPD | |
| **7.** | Bosillovë | Zoran Zimbakov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Zoran Zimbakov |
| | | Lupço Kolev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **8.** | Bërvenicë | Seljatin Jusufi | Lëvizja Besa | |
| | | Enver Pajaziti | Grup zgjedhësish | Enver Pajaziti |
| | | Mirko Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Stojan Todoroski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **9.** | Butel | Vllatko Damjanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Ermond Miftari | PDSH | |
| | | Velimir Smilevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Velimir Smilevski |
| | | Naser Curri | BESA | |
| **10.** | Vallandovë | Pero Kostadinov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Pero Kostadinov |
| | | Stojan Manolev | Grup zgjedhësish | |
| | | Nikolçe Çurlinovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **11.** | Vasilevë | Marjan Janev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Marjan Janev |
| | | Vanço Stojanov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **12.** | Vevçan | Sasho Jankoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Sasho Jankoski |
| | | Cvetomir Ugrinoski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **13.** | Veles | Ace Kocevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Ace Kocevski |
| | | Sllavço Çadiev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **14.** | Vinicë | Ivica Dimitrov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Ivica Dimitrov |
| | | Martin Pavllov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **15.** | Vrapçisht | Erdal Ahmedi | PDTM | |
| | | Sami Aliji | PDSH | |
| | | Daut Demiri | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Rexhep Rexhepi | Lëvizja BESA | |
| | | Gajur Rushiti | BDI | |
| | | Isen Shabani | Partia politike Aleanca për shqiptarët | Isen Shabani |
| **16.** | Gazibabë | Boris Georgievski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Boris Georgievski |
| | | Toni Trajkovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Zoran Trpçevski | LEVICA | |
| **17.** | Gjevgjeli | Sasho Pockov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Sasho Pockov |
| | | Ivan Frangov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **18.** | Gostivar | Asaf Ademi | BESA | |
| | | Nevzat Bejat | BDI | |
| | | Shpat Iseini | Koalicioni Aleanca për shqiptarët | |
| | | Selajdin Izairi | PDSH | |
| | | Lenka Jovanovska | PSDM | |
| | | Dafina Stojanovska | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Arben Taravari | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | Arben Taravari |
| **19.** | Gradskë | Robert Beshovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Robert Beshovski |
| | | Ivançe Ivanov | Grup zgjedhësish | |
| | | Ligur Kocev | Grup zgjedhësish | |
| | | Zhaklina Çaushevska | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **20.** | Dibër | Arben Agolli | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Dragan Klopçevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Ruzhdi Lata | BDI | Ruzhdi Lata |
| | | Xhemail Çupi | PDSH | |
| | | Shkëlqim Xhafa | Koalicioni Aleanca për shqiptarët | |
| **21.** | Debarcë | Jadranka Biban | Grup zgjedhësish | |
| | | Zoran Nogaçeski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zoran Nogaçeski |
| | | Igor Trajkoski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **22.** | Dellçevë | Ivan Sokollov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Goran Trajkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Goran Trajkovski |
| **23.** | Demir Kapi | Trajçe Dimitriev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Llazar Petrov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Llazar Petrov |
| **24.** | Demir Hisar | Lupço Bllazhevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Marjançe Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Marjançe Stojanovski |
| **25.** | Dojran | Toni Ajcev | Grup zgjedhësish | |
| | | Ango Angov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Ango Angov |
| | | Snezhana Maneva | Grup zgjedhësish | |
| | | Borçe Stamov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **26.** | Dollnen | Erol Abdiu | PDSH | |
| | | Exhevit Ajdaroski | Lëvizja për Unitet nacional të Turqve | |
| | | Peco Vajgaleski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Zekirija Jusufi | Partia politike Aleanca për shqiptarët | |
| | | Bilal Karishik | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Ismet Qamili | Lëvizja BESA | |
| | | Xhemil Qamili | BDI | Xhemil Qamili |
| **27.** | Gjorçe Petrov | Vllado Misajllovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Aleksandar Naumovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Aleksandar Naumovski |
| **28.** | Zhelinë | Sali Ajdini | PDSH | |
| | | Reshat Alii | Partia politike Aleanca për shqiptarët | |
| | | Fatmir Izairi | BDI | |
| | | Blerim Sejdi | Lëvizja BESA | Blerim Sejdi |
| **29.** | Zelenikovë | Borçe Gievski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Borçe Gievski |
| | | Aleksandar Manevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **30.** | Zërnocë | Kiro Kocev | Partia Socialdemokrate e Maqedonisë | |
| | | Vanço Mitev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Metodi Nikollov | Grup zgjedhësish | |
| | | Bllazhe Stankov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Bllazhe Stankov |
| **31.** | Ilinden | Martina Ivkovska | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Zhika Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Zhika Stojanovski |
| **32.** | Jegunovcë | Orhan Amiti | BDI | |
| | | Darko Bllazheski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Darko Bllazheski |
| | | Besar Emini | Lëvizja BESA | |
| | | Toni Koceski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **33.** | Kavadar | Verica Arsova | BPRM | |
| | | Boris Davidov | Kandidat i pavarur | |
| | | Mitko Jançev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Mitko Jançev |
| | | Betiane Kitev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **34.** | Karbincë | Zoran Minov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Jordan Nasev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Jordan Nasev |
| | | Goran Paunov | Lëvizja Popullore për Maqedoni | |
| **35.** | Karposh | Stefan Bogoev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Stefan Bogoev |
| | | Stefçe Jakimovski | OPQM | |
| **36.** | Kisellavodë | Johan Tarqullovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Filip Temelkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Filip Temelkovski |
| **37.** | Kërçovë | Fatmir Dehari | BDI | Fatmir Dehari |
| | | Vllatko Sajkoski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **38.** | Konçë | Bllagoj Iliev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Bllagoj Iliev |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Bllagoj Jovanov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **39.** | Koçanë | Ratko Dimitrovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Nikollçe Ilijev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Nikollçe Ilijev |
| **40.** | Kratovë | Mite Andonovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Lupço Bojaxhiev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Lupço Bojaxhiev |
| **41.** | Kriva Pallankë | Arsenço Aleksovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Borjanço Micevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Borjanço Micevski |
| **42.** | Krivogashtanë | Toni Zatkoski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Rubinco Shefteroski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Rubinco Shefteroski |
| **43.** | Krushevë | Gjorgji Damçeski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Tome Hristoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Tome Hristoski |
| **44.** | Kumanovë | Zoran Gjorgjievski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Maksim Dimitrevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Maksim Dimitrevski |
| | | Bashkim Osmani | Partia politke Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Driton Sulejmani | BESA | |
| **45.** | Likovë | Bekim Afuzi | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Erkan Arifi | BDI | Erkan Arifi |
| | | Bardhyl Destani | PDSH | |
| | | Shaban Zendeli | Lëvizja BESA | |
| | | Hadi Osmani | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **46.** | LLozovë | Aco Vellkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Aco Vellkovski |
| | | Gorjan Ivanov | Lëvizja popullore për Maqedoni | |
| | | Jordan Ilievski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **47.** | Mavrovë dhe Rostushë | Alim Bilali | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Nahmir Gale | Grup zgjedhësish | |
| | | Medat Kurtovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Medat Kurtovski |
| **48.** | M. Kamenicë | Darko Mitevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Sonja Stamenkova | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Sonja Stamenkova |
| **49.** | M. Brod | Millosim Vojneski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Zharko Zllateski | Grup zgjedhësish | |
| | | Zhivko Siljanoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zhivko Siljanoski |
| | | Dragisha Terzioski | Partia socialdemokrate e Maqedonisë | |
| **50.** | Mogillë | Jasmina Gullevka | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Jasmina Gullevka |
| | | Stevo Pivkovski | Grup zgjedhësish | |
| | | Zorançe Sakurmovski | Lëvizja popullore për Maqedoni | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **51.** | Negotinë | Zllatko Penkov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Toni Dellkov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Toni Dellkov |
| **52.** | Novaci | Llazar Kotevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Lube Kuzmanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Lube Kuzmanovski |
| | | Peco Micevski | Grup zgjedhësish | |
| **53.** | Novosellë | Blllazho Vellkov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Boro Stojçev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Boro Stojçev |
| | | Dragan Trajkov | Lëvizja popullore për Maqedoni | |
| **54.** | Ohër | Jovan Stojanoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Jovan Stojanoski |
| | | Stevçe Stevoski | Kandidat i pavarur | |
| | | Mitko Tilevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **55.** | Petrovec | Zvonko Cvetkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Borçe Mitevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Borçe Mitevski |
| **56.** | Pehçevë | Igor Popovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Dragan Trençovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Dragan Trençovski |
| **57.** | Pllasnicë | Shpresim Ajroski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Ismail Jahoski | BDI | Ismail Jahoski |
| **58.** | Prilep | Marjan Risteski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Ilija Jovanoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Ilija Jovanoski |
| **59.** | Probishtip | Dragan Atanasov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Dragan Atanasov |
| | | Goran Stoilkovski | Grup zgjedhësish | |
| | | Toni Tonevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **60.** | Radovish | Jure Gjorgjiev | Grup zgjedhësish | |
| | | Gerasim Konzullov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Gerasim Konzullov |
| | | Sashko Nikollov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **61.** | Rankovcë | Robert Simonovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Ivica Toshevski | Grup zgjedhësish | Ivica Toshevski |
| **62.** | Resnjë | Gjoko Strezovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Zhivko Gosharevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zhivko Gosharevski |
| **63.** | Rosoman | Branko Janev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Branko Janev |
| | | Stojançe Llazov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **64.** | Saraj | Ekrem Alija | Partia Politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Sefedin Aliu | PDSH | |
| | | Bashkim Bakiu | BESA | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Blerim Bexheti | BDI | Blerim Bexheti |
| **65.** | Sveti Nikollë | Sasho Vellkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Sasho Vellkovski |
| | | Zoran Tasev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **66.** | Sopishtë | Dalibor Bogdanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Stefçe Trpkovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Stefçe Trpkovski |
| **67.** | S. Nagoriçanë | Elena Jaqimoviq | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Zhaklina Jovanovska | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Zhaklina Jovanovska |
| | | Millosh Stojmanovski | Lëvizja popullore për Maqedoni | |
| **68.** | Strugë | Vasil Ashtallkoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Ramiz Merko | BDI | Ramiz Merko |
| | | Nasto Palioski | LPM | |
| | | Ziadin Sela | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Sejad Sollakoski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **69.** | Strumicë | Marjan Bajraktarov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Kosta Janevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Kosta Janevski |
| **70.** | Studeniçan | Mexhit Imeri | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Femi Jonuzi | BDI | |
| | | Rexhep Memeti | Lëvizja BESA | |
| | | Akija Mustafovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| | | Azem Sadiki | PDSH | Azem Sadiki |
| **71.** | Tearcë | Isen Asani | BDI | Isen Asani |
| | | Nevzat Velijii | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Vojo Gogovski | VMRO-DPMNE | |
| | | Amir Elezi | Lëvizja BESA | |
| | | Ruhan Ilazi | PDSH | |
| | | Bobi Petrushevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **72.** | Tetovë | Teuta Arifi | BDI | Teuta Arifi |
| | | Bardhyl Dauti | PDSH | |
| | | Bilal Kasami | BESA | |
| | | Goran Manojllovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Adnan Neziri | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| **73.** | Qendër | Sasha Bogdanoviq | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Sasha Bogdanoviq |
| | | Dejan Jovanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Aleksander Mitrov | LEVICA | |
| **74.** | Qendër Zhupë | Arijan Ibraim | Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni | Arijan Ibraim |
| | | Nevaip Ismail | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **75.** | Çair | Faruk Avdiu | Partia politike Aleanca për Shqiptarët | |
| | | Ismail Bojda | LPM | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Visar Ganiu | BDI | Visar Ganiu |
| | | Zeqirija Ibrahimi | BESA | |
| | | Idriz Orhana | PDSH | |
| | | Nermin Tellovska | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **76.** | Çashkë | Zoran Zdravevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| | | Goranço Panovski | Lëvizja popullore për Maqedoni | |
| | | Goran Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Goran Stojanovski |
| **77.** | Çeshinovë – Obleshevë | Goranço Zashov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | Goranço Zashov |
| | | Goranço Krstev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | |
| **78.** | Çuçer Sandev | Jovan Pejkovski | Grup zgjedhësish | Jovan Pejkovski |
| | | Aco Popovski | Grup zgjedhësish | |
| | | Goran Çekalloviq | Lëvizja popullore për Maqedoni | |
| **79.** | Shtip | Bllagoj Boçvarski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Bllagoj Boçvarski |
| | | Ilço Zahariev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | |
| **80.** | Shuto Orizare | Elvis Bajrami | LRM | |
| | | Kurto Dudush | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | Kurto Dudush |
| | | Faik Sadiki | PDSH | |
| | | Muhamed Curri | BESA | |
| | | Xhelal Çajani | BDI | |

Pra, këto zgjedhje ndryshuan numrat në pushtetin lokal:

- Koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 57 vende të kryetarëve të komunave;
- Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 5 vende të kryetarëve të komunave;
- BDI fitoi 10 vende të kryetarëve të komunave;
- Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, fitoi 3 vende të kryetarëve të komunave;
- BESA, fitoi 1 komunë;
- PDSH, fitoi një komunë;
- PDT, fitoi një komunë; dhe
- 3 komuna u fituan nga kandidatë të pavarur[74].

[74] Po aty, f. 155

### 3.3.2. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave në RMV

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga gjithsej 80 komuna dhe qyteti i Shkupit ka gjithsej 1347 këshilltarë.

**TABELA 4:**

**Komunat dhe numri i kandidatëve/i këshilltarëve[75]**

| Nr. | Komuna | Nr. i kandidatëve të paraqitur | Numri i Këshilltarëve |
|---|---|---|---|
| 1 | Aerodrum | 81 | 27 |
| 2 | Haraçinë | 60 | 15 |
| 3 | Berovë | 30 | 15 |
| 4 | Manastir | 248 | 31 |
| 5 | Bogdaancë | 33 | 11 |
| 6 | Bogovinë | 76 | 19 |
| 7 | Bosillovë | 30 | 15 |
| 8 | Bërvenicë | 90 | 15 |
| 9 | Butel | 133 | 19 |
| 10 | Vallandovë | 30 | 15 |
| 11 | Vasilevë | 45 | 15 |
| 12 | Vevçan | 18 | 9 |
| 13 | Veles | 138 | 23 |
| 14 | Vinicë | 45 | 15 |
| 15 | Vrapçishtë | 133 | 19 |
| 16 | Gazibabë | 108 | 27 |
| 17 | Gjevgejli | 95 | 19 |
| 18 | Gostivar | 279 | 31 |

[75] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë për rezultatet e sublimuara nga votimi sipas komunave, 30.10.2017, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2017/.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **19** | Gradskë | 27 | 9 |
| **20** | Dibër | 105 | 15 |
| **21** | Debarcë | 33 | 11 |
| **22** | Dellçevë | 30 | 15 |
| **23** | Demir Kapi | 18 | 9 |
| **24** | Demir Hisar | 22 | 11 |
| **25** | Dojran | 27 | 9 |
| **26** | Dollnenë | 120 | 15 |
| **27** | Gjorçe Petrov | 92 | 23 |
| **28** | Zhelinë | 95 | 19 |
| **29** | Zelenikovë | 54 | 9 |
| **30** | Zërnocë | 27 | 9 |
| **31** | Ilinden | 45 | 15 |
| **32** | Jegunovcë | 105 | 15 |
| **33** | Kavadar | 95 | 19 |
| **34** | Karbincë | 36 | 9 |
| **35** | Karposh | 92 | 23 |
| **36** | Kisellavodë | 46 | 23 |
| **37** | Kërçovë | 138 | 23 |
| **38** | Konçë | 36 | 23 |
| **39** | Koçanë | 57 | 19 |
| **40** | Kratovë | 30 | 15 |
| **41** | Kriva Pallankë | 57 | 19 |
| **42** | Krivogashtanë | 33 | 11 |
| **43** | Krushevë | 77 | 11 |
| **44** | Kumanovë | 264 | 33 |
| **45** | Likovë | 114 | 19 |
| **46** | LLozovë | 36 | 9 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **47** | Mavrov dhe Rostushë | 55 | 11 |
| **48** | M. Kamenicë | 22 | 11 |
| **49** | M. Brod | 165 | 11 |
| **50** | Mogillë | 55 | 11 |
| **51** | Negotinë | 45 | 15 |
| **52** | Novacë | 27 | 9 |
| **53** | Novosellë | 30 | 15 |
| **54** | Ohër | 115 | 23 |
| **55** | Petrovec | 66 | 11 |
| **56** | Pehçevë | 22 | 11 |
| **57** | Pllasnicë | 27 | 9 |
| **58** | Prilep | 81 | 27 |
| **59** | Probishtip | 60 | 15 |
| **60** | Radovish | 114 | 19 |
| **61** | Rankovcë | 27 | 9 |
| **62** | Resnje | 60 | 15 |
| **63** | Rosoman | 36 | 9 |
| **64** | Saraj | 95 | 19 |
| **65** | S. Nikollë | 30 | 15 |
| **66** | Sopishtë | 66 | 11 |
| **67** | S. Nagoriçanë | 45 | 9 |
| **68** | Strugë | 162 | 27 |
| **69** | Strumicë | 46 | 23 |
| **70** | Studeniçan | 120 | 15 |
| **71** | Tearcë | 133 | 19 |
| **72** | Tetovë | 248 | 31 |
| **73** | Qendër | 46 | 23 |
| **74** | Qendër Zhupë | 55 | 11 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **75** | Çair | 216 | 27 |
| **76** | Çashkë | 44 | 11 |
| **77** | Çeshinovë – Obleshevë | 33 | 11 |
| **78** | Çuçer Sandev | 77 | 11 |
| **79** | Shtip | 92 | 23 |
| **80** | Shuto Orizare | 114 | 19 |
| | **Gjithsej** | | **1302** |

**TABELA 5[76]:**

**Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave**

| **Partia politike** | **LSDM** | **VMRO-DPMNE** | **BDI** | **ASH** | **PDSH** | **Levica** | **Besa** | **PDT** | **LPM/LRM** | **PPD** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i këshilltarëve të fituar | 552 | 432 | 127 | 63 | 23 | 3 | 63 | 17 | 7 | 1 |

### 3.3.3. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetar dhe këshilltar të Qytetit të Shkupit

Përpos zgjedhjeve të kryetarëve të komunave në veçanti Edhe zgjedhja për të parin e qytetit të Shkupit e cila është shumë e rëndësishme në procesin politik duke mos e harruar se edhe këshilli i qytetit të Shkupit ka një rëndësi të madhe.

Në zgjedhjet e vitit 2017 nga gjithsej 29 komuna kanë paraqitur kandidat për kryetar të qytetit të Shkupit ishin gjithsej 5 kandidat dhe 405 garues për këshilltar të qytetit të Shkupit.

Kandidatë për Kryetar të Qytetit të Shkupit ishin:

-Naim Bajrami nga Partia politike Aleanca për Shqiptarët;

[76] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë për rezultatet e sublimuara nga votimi sipas komunave, 30.10.2017, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2017/.

- Koce Trajanovski nga Koalicioni i udhëhequr nga VMRO – DPMNE;
- Gjorgji Todorov nga  Lëvizja Popullore për Maqedoni;
- Bekim Fazliu nga PDSH;
- Nafie Selmani nga BESA;
- Marija Xhons nga LEVICA;
- Petre Shilegov nga Koalicioni i udhëhequr nga LSDM; dhe
- Vanço Shehtanski nga BPRM[77].

Me rrethin e parë në zgjedhjet lokale të vitit 2017 qytetin e Shkupit e fitoi kandidati Petre Shilegove nga koalicioni i udhëhequr i LSDM, dhe po ashtu fituan edhe një numër më të madh të këshilltarëve nga partitë e tjera.

Për zgjedhjen e këshilltarëve në Qytetin e Shkupit;

LSDM fitoi 122.711 vota (43,7%);

VMRO-DPMNE - 96.922 vota (34,5%);

BDI - 17.100 (6,1%);

Lëvizja BESA - 13.882 (4,9%);

Aleanca për Shqiptarët - 6.972 (2,4%); dhe

LEVICA 5922 (2,1%)[78].

Sipas kësaj, nga gjithsej 45 vende të këshilltarëve në Këshillin e Qytetit të Shkupit:

LSDM fitoi 21 këshilltarë;

VMRODPMNE: 17;

BDI: 3;

Lëvizja BESA: 2;

Aleanca për Shqiptarët: 1 dhe,

LEVICA: 1[79].

---

[77] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.73 - 75

[78] Jane Dimeski, Marko Pankovski, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Botimi i dytë, 2017. f.154.

[79] Po aty, f. 155

### 3.3.4.Jehona e zgjedhjeve lokale të tetorit 2017 dhe analiza krahasimore me zgjedhjet paraprake

Kur flasim për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga vitet e hershme gjegjësisht nga vitit 1996 deri në zgjedhjet e vitit 2017 do të shohim lëvizje të deponimit të votuesve, jehona e votuesve nuk ka qenë gjithmonë e njëjtë, por mund të themi se shpesh se me një nxitje apo shtyrje është dashur të jepet që të kalohet mundësia apo të përmbushen kushtet që zgjedhjet mos të dështojnë.

**Grafiku 1:**

**Jehona e zgjedhjeve lokale 1996 - 2017**




Sikurse edhe që shihet nga fotoja që në dy rrethet e zgjedhjeve në zgjedhjet lokale kemi pasur jehon të ndryshme të votuesve në zgjedhje, si jehonë më të lartë të votuesve kemi pasur në vitin 2013 ku në rrethin e parë kemi pasur një dalje prej 67 % të votuesve të regjistruar, kurse në rrethin e dytë kemi pasur 65% të votuesve që është numri më i lartë ndonjëherë i daljes së votuesve në zgjedhje lokale në të dy rrethet, kurse interes më të ulët deri në vitin 2017 është treguar në zgjedhjet e vitit 2005 në rrethin e parë prej 56.36% të votuesve, kurse në rrethin e dytë dalje më të ulët ka pasur në vitin 2009 me vetëm 43% të votuesve, ndërkaq, viti 2013 ka qenë me jehonë më të lartë edhe përskaj asaj që në vitin 2017 është udhëhequr një kampanjë apo fushatë më e mirëfilltë, ku pjesa më e madhe e partive kanë qenë në koalicione me parti

tjera për të mirën e popullit, por numri i votuesve që e kanë shfrytëzuar të drejtën e votimit ka qenë në rënie për dallim nga ai i vitit 2013, duke mos harruar një pjesë e tyre edhe kanë qenë në vendet e mërgimit dhe ndoshta kjo e ka bërë që mos të ketë mundësin për pjesëmarrje në zgjedhjet e vitit 2017.

Jehona e vitit 2017 për nga renditje e saj është në vendin e tretë për rrethin e parë të zgjedhjeve, kurse për rrethin e dytë është në vendin e katërt për të drejtën e votimit të cilën e kanë shfrytëzuar votuesit.

### 3.4. Mbrojtja juridike administrative dhe gjyqësore e të drejtës zgjedhore në zgjedhjet lokale të tetorit 2017

Korniza juridike parasheh një proces të centralizuar të kundërshtimeve ditën e zgjedhjeve, me ç'rast KSHZ vendos mbi lëndët e parashtruara vetëm të pjesëmarrësve në zgjedhje dhe për parregullsitë në zgjedhje dhe numërimin dhe mbledhjen e rezultateve, me çrast këto vendime të KSHZ-së mund të goditen para Gjykatës Administrative, ndërkaq, pjesëmarrësit në zgjedhje kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtime në afat prej 48 orëve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, kështu që, gjatë këtyre zgjedhjeve lokale të vitit 2017, KSHZ brenda afatit ligjor pranoi 46 kundërshtime pas zgjedhjeve nga rrethi i parë, të cilët më së shumti ishin të parashtruara nga koalicioni opozitar, ku prej tyre më së shumti i referohen parregullsive të vogla, përderisa të gjithë kërkojnë anulimin e rezultateve zgjedhore, por, KSHZ i refuzoi të gjitha kundërshtimet, ku edhe pse shumë raste kanë qenë të analizuara në esencë, thelbi i tyre varionte; pra, në disa raste, bazat për refuzim ishin të paarsyshme, kurse në disa të tjera mungonte baza solide juridike dhe e qartë, ndërkaq, në disa raste të tjera shqyrtimi ishte shkurtuar në baza teknike, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare dhe, mënyra se si është vepruar në këto zgjedhje nga ana e KSHZ-së siç shihet edhe në raportet mbi këto zgjedhje të mbikëqyrësve e ka rrezikuar sundimin e së drejtës dhe procesin e garantuar, në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia e OSBE-së ku, edhe pse nuk është kujdesur afati prej 48 orëve, KSHZ të

gjitha lëndët i ka zgjidhur në seanca të hapura, kurse kundërshtimet dhe vendimet menjëherë kanë qenë të publikuara në uebfaqen e KSHZ-së[80].

28-të vendime të KSHZ-së përfunduan përpara Gjykatës Administrative, thuajse të gjitha në afatin e paraparë prej 24 orëve[81]. Në lidhje me veprimin dhe vendosjen e Gjykatës Administrative, siç qëndron edhe në njoftimet e saj, pas marrjes së padive kundër vendimeve të KSHZ-së, të deklaruara nga dorëzuesit e listave kandiduese në lidhje me mbajtjen e zgjedhjeve lokale të vitit 2017, Gjykata Administrtive solli vendim për të gjitha 28-të paditë[82].

Mbi vërejtjet e Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017, gjendjen faktike mbi parregullsitë dhe shkeljen e të drejtës së zgjedhjeve e pati konstatuar edhe Avokati i Popullit, në disa segmente[83].

Kronologjia e zhvillimit të këtij procesi përpara Gjykatës Administrative rrjedh si në vijim: Partia politike Aleanca për Shqiptarët më datë 21.09.2017 parashtroi padi përpara Gjykatës Administrative kundër vendimit të KSHZ-së dhe përgjigjen e kundërshtimit nr. 11-2014/2 nga 21.09.2017 për KKZ-në Gostivar; Gjykata Administrative me vendim nr. UPR nr. 130/2017, padinë e paditësit Aleanca për Shqiptarët kundër vendimit nr. UP1 11-2014/2 nga 21.09.2017 të KSHZ-së e refuzoi si të pabazë[84].

Kundërshtimet e parashtruara për mbrojtje të të drejtës zgjedhore të zgjedhësve në përputhje me nenin 149 të Kodit Zgjedhor, deri te KSHZ-ja nga ana e zgjedhësve kanë qenë të parashtruara 11 kundërshtime për mbrojtje personale të të drejtës zgjedhore, ku KSHZ duke i shqyrtuar të gjitha kundërshtimet, me të cilët me vendim vendosi në vijim:

- 9 kundërshtime u pranuan dhe,

---

[80] Изјава за првичните наоди и заклучоци, Набљудувачка мисија за избори, Локални избори, Втор круг, 29 октомври 2017, në linkun në dispozicion: https://www.osce.org/files/f/documents/2/c/353291.pdf.
[81] Po aty.
[82] Соопштение за јавноста, Управен суд, 23.10.2017, në linkun në dispozicion: http://www.vsrm.mk/wps/portal/usskopje/sud/vesti/e73743e7-125d-47e6-8361-e9ee201cc42e/!ut/p/z0/jYxLDoIwFADP4oJl8x5Q27pEY0z8bNQFdmNKeWoFC0rxc3v1AsblJDMDGnLQ3tzd0QTXeFN_eKfFXsw4R7XApdqsx5hNUartKEOcSpiD_i18DsltNVkdQbcmnJjzhwZykqnkKUkWJ8OScUmCqVTEjEZECcbW8oS-qTtfrzoDbRsf6Bkgb_uidnZ_qSLs-jLCtrEUvInwTl1wEf41bitdvB7Z4A0KFCQl/.
[83] Годишен извештај за степенот на обезбедувањето, почитувањето, унапредувањето и заштита на човековите слободи и права 2017, Народен правобранител, në linkun në dispozicion: https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2017/GI-2017.pdf.
[84] Извештај за спроведување избори на советите на општините и советот на Град Скопје и за градоначалници на општините и за градоначалник на Град Скопје, në dispozicion në linkun: https://drive.google.com/file/d/1TikLdNzuV-pABg12HX4okeu2fj1lXF-F/view.

- 2 kundërshtime u refuzuan; ndërkaq, KSHZ me vendim miratoi 9 kundërshtime të parashtruara nga ana e personave të sëmurë dhe të pafuqishëm mbi bazën e nenit 149-a të Kodit Zgjedhor dhe e detyroi KKZ-në që t'u mundësohet parashtruesve të kundërshtimeve të votojnë si persona të sëmurë dhe të pafuqishëm, në përputhje me nenin 111 të Kodit Zgjedhor; KSHZ i refuzoi 2 kundërshtime të parashtruara mbi bazën e nenit 149-a prej të cilëve 1 kundërshtim e refuzoi për shkak se personi i lajmëruar si i sëmurë dhe i pafuqishëm nuk ka qenë i gjendur në shtëpinë e tij më datë 14 tetor 2017 dhe 1 kundërshtim është refuzuar për shkak se parashtruesi i kundërshtimit e nxorri dokumentin personal më datë 15 09 2017, pas shpalljes së zgjedhjeve (më 06 08 2017) dhe në kohën e këqyrjes publike (21 08 – 09 09 2017) nuk është lajmëruar në njësinë e rajonit dhe zyrat e KSHZ-së që të kryejë të dhëna plotësuese në Listën Zgjedhore[85].

Në ditën e votimit në rrethin e parë të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më 15 tetor 2017, në përputhje me nenin 149 të Kodit Zgjedhor, deri te KSHZ-ja nga ana e qytetarëve arritën 47 kundërshtime për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore, ku KSHZ-ja duke i shqyrtuar të njëjtat vendosi si në vijim:

- 38 kundërshtime u refuzuan për shkak të bazave në vijim:
- Nxjerrja e kartës së identitetit pas shpalljes së zgjedhjeve, kurse parashtruesi në kohën e këqyrjes publike nuk është paraqitur në njësitë e rajonit dhe zyrat e KSHZ-së-19 kundërshtime;
- Nxjerrja e kartës së identitetit pas përfundimit të këqyrjes publike – 6 kundërshtime;
- Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për parashtruesin – 4 kundërshtime;
- Nuk ka dokument personal valid në ditën e shpalljes së zgjedhjeve – 7 kundërshtime dhe
- Vendim i shlyer – 2 kundërshtime;
- 7 kundërshtime nuk miratohen për shkak të bazave më poshtë:
- Në vendin e parashtruesit të kundërshtimit të listës zgjedhore është nënshkruar një person tjetër – 1 kundërshtim;
- Personi është gjendur në certifikatën e veçantë të listës zgjedhore – 1 kundërshtim;
- Personi është gjendur në listën zgjedhore në adresën e vjetër – 1 kundërshtim;

[85] Ibid.

- Personi është gjendur në listën zgjedhore – 2 kundërshtime;
- Personi është gjendur në certifikatën e veçantë të listës zgjedhore për votim në KPD – 1 kundërshtim dhe,
- Personi është gjendur në listën zgjedhore të mbiemrit të vajzërisë – 1 kundërshtim;

- ndërkaq, 2 kundërshtime refuzohen për shkak të bazave si më poshtë:

- kundërshtimet janë të parregullta dhe nuk përmbajnë të dhëna të mjaftueshme që të veprohet sipas tyre – 2 kundërshtime[86].

**TABELA 6[87]:**

**Analiza e kundërshtimeve, vendimeve dhe aktgjykimeve nga rrethi i parë zgjedhor**

| | UP1 numër dhe data e parashtrimit | OIK IM | Parashtruesi | Kryetarët | Këshilli | Vendimet e KSHZ-së | Paditë dhe vendimet e GJA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | UP1 11-52 nga 16.10.2017<br>UP1 11-55/1 nga 17.10.2017<br>UP1 11-81/1 nga 17.10.2017 | IKGS<br>Të gjitha 675 IM | TMRO | Qyteti i Shkupit | Qyteti i Shkupit | Hudhet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 144/2017 |
| 2. | UP1 11-53 nga 17.10.2017 | Gostivar 0387/1 | A/A | Gostivar | / | Hudhet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 171/2017 |
| 3. | UP1 11-57/1 nga 17.10.2017 | Aerodrom 2772/1 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | / | Refuzohet | Nuk është parashtruar padi |

[86] Ibid.

[87] Извештај за спроведување избори на советите на општините и советот на Град Скопје и за градоначалници на општините и за градоначалник на Град Скопје, në dispozicion në linkun: https://drive.google.com/file/d/1TikLdNzuV-pABg12HX4okeu2fj1lXF-F/view.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | UP1 11-58/1 nga 17.10.2017 | Karposh 2593, 2614, 2618, 2637, 2639, 2640, 2645, 2647, 2648, 2649 dhe 2651 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | Qyteti i Shkupit | Të tërhequra | / |
| 5. | UP1 11-59/2 nga 17.10.2017 | Aerodrom 2757 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | Qyteti i Shkupit | Refuzohet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 153/2017 |
| 6. | UP1 11-60/2 nga 17.10.2017 | Struga 1845 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Strugë | Strugë | Refuzohet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 158/2017 |
| 7. | UP1 11-61/4 nga 17.10.2017 | Karposh 2616, 2637, 2645, 2647, 2648 dhe 2651 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | Qyteti i Shkupit | Të tërhequra | / |
| 8. | UP1 11-62/1 nga 17.10.2017 | Qendër 2859 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qendër | / | Refuzohet | Nuk është parashtruar padi |
| 9. | UP1 11-63/1 nga 17.10.2017 | Qendër 2870 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | / | Refuzohet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 161/2017 |
| 10. | UP1 11-64/1 nga 17.10.2017 | Gjorçe Petrov 2582/1 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | / | Refuzohet | Vërtetohet vendimi i KSHZ-së/URP. Nr. 165/2017 |
| 11. | UP1 11-65/1 nga 17.10.2017 | Qendër 2845 | Koalicioni VMRO-DPMNE | / | Qyteti i Shkupit | Të tërhequra | / |
| 12. | UP1 11-66/1 nga 17.10.2017 | Qendër 2854 | Koalicioni VMRO-DPMNE | / | Qyteti i Shkupit | Refuzohet | Nuk është parashtruar padi |
| 13. | UP1 11-67/2 nga 17.10.2017 | Gjorçe Petrov 2563, 2567, 2587 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Qyteti i Shkupit | / | Refuzohet | Vërtetohet vendimi i KSHZ/URP nr. 162/2017 |
| 14. | UP1 11-68/1 nga | Radovish 1578 | Koalicioni VMRO-DPMNE | Radovish | Radovish | Refuzohet | Nuk është parashtruar padi |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 17.10.2017 | | | | | | |
